



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**T R A N S K R I P T**

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 9 DHE 12 KORRIK 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,  
ODRŽANE 9. I 12. JULA 2018. GODINE**

**KORRIK - JUL  
2018**

## **Rendi i ditës**

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

## **Dnevni red**

1. Prvo razmatranje Nacrt zakona o Posebnoj komori Vrhovnog suda u vezi pitanja Kosovske agencije za privatizaciju

## **Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.**

KRYETARI: Të nderuar deputetë, Vazhdojmë me pikën e rendit të ditës:

### **1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin në parim dhe Kuvendit i ka rekomanduar mosmiratimin e tij.

Ministri i Drejtësisë, zoti Abelard Tahiri, e ka fjalën ta paraqesë para deputetëve dhe ta arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë

I nderuar ministër,

Para se të prezantoj ndryshimet kyçe që parasheh ky projektligj, më lejoni që së pari të paraqes një historik të shkurtër që qëndron pas themelimit të kësaj Gjykate të Specializuar.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme është themeluar që nga viti 2002, në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/13.

Kjo gjykatë u themelua menjëherë pas themelimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe që nga themelimi i saj ka pasur kompetencë ekskluzive trajtimin e lëndëve që vijnë, pra kontesteve nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, e më pas trashëgimtarja e asaj, Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Pra, Dhoma e Posaçme shqyrton kërkesat apo ankesat që dalin apo kanë lidhje me procesin e privatizimit nga AKM-ja më parë, apo AKP-ja tani.

Kërkesa apo ankesa e punëtorëve për 20%, kërkesat e përgjithshme pronësore apo kreditore në lidhje me ndërmarrjet shoqërore, kërkesa nga likuidimi apo riorganizimi i një ndërmarrje shoqërore.

Të nderuar deputetë,

Dhoma e Posaçme, për shkak të natyrës së lëndëve, të cilat bien kompetencë e saj, kontestet që kishin të bënin me pronën publike dhe shoqërore ishte paraparë si një Gjykatë e Specializuar, e cila nuk do të bënte pjesë e gjykatave të rregullta.

Kjo kryesisht pasi që fillimi është paraparë që të shqyrtonte si shkallë e fundit, duke e shmangur kështu edhe juridiksionin e Gjykatës Supreme.

Pra, fillimisht shumica e gjyqtarëve në këtë gjykatë kanë qenë gjyqtarë ndërkombëtarë, të emëruar nga përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe më pastaj ishin gjyqtarë vendorë.

Pra, fillimisht ka funksionuar si një gjykatë njëshkallëshe, duke vendosur një trup gjykues, pra vendimet e saj kanë qenë përfundimtare, të paapelueshme dhe të detyrueshme për palët.

Me ndryshimet ligjore që kanë pësuar gradualisht kanë ndryshuar struktura, ashtu edhe përbërja e gjykatës.

Me Rregulloren e UNMIK-ut 2008/4 u ndryshua Rregullorja 2002/13, duke bërë këtë gjykatë dyshkallësh si dhe u rrit numri i gjyqtarëve deri në 20, 13 prej tyre ndërkombëtarë, ndërsa 7 vendorë.

Në shkallën e parë gjykonin pesë kolegje gjyqësore të specializuara, ku secili panel përbëhej nga tre gjyqtarë, dy ndërkombëtarë dhe një vendor.

Kurse në shkallën e dytë, Kolegji i Apelit, i cili përbëhej nga pesë anëtarë, tre gjyqtarë ishin ndërkombëtarë dhe dy vendorë.

Nga janari i vitit 2012 me ndryshimet në Ligjin për Dhomën e Posaçme u ndryshua edhe përbërja e gjyqtarëve, ku numri i gjyqtarëve ndërkombëtarë u zvogëlua dhe numri i gjyqtarëve vendorë u rrit në 13, ndërsa numri i gjyqtarëve ndërkombëtarë në shtatë, pra e kundërta deri në atë vit.

Në vitin 2014, si pasojë e ndryshimeve të mandatit të EULEX-it, Kolegji i Apelit u përbë me shumicë të gjyqtarëve vendorë, pra edhe këtu tanimë kishim tre gjyqtarë vendorë dhe dy ndërkombëtarë.

Duke u kthyer te projektligji për shqyrtim, si pasojë e ndryshimeve të mandatit të EULEX-it në gjyqësor, të cilët kanë hyrë në fuqi më 14 qershor të vitit 2018, ndryshimi i ligjit aktual është një veprim esencial sa i përket funksionimit të kësaj gjykate.

Siç e përmenda më lart, në përshkrimin e kësaj gjykate korniza ligjore aktuale e Dhomës së Posaçme parasheh përbërjen prej dy gjyqtarëve vendorë dhe një ndërkombëtar.

Duke qenë se gjyqtarët ndërkombëtarë të EULEX-it u ka përfunduar mandati, ndryshimet në strukturën e cili parasheh ky ligj janë të domosdoshme për të garantuar vazhdimësinë e punës pas largimit të gjyqtarëve ndërkombëtarë.

Theksoj se për shkak të kompetencës ekskluzive të kësaj gjykate në çështje që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, puna e kësaj gjykate ndikon drejtpërdrejt në dinamikën e procesit të privatizimit, e sidomos të shpërndarja e fondeve në mirëbesim të punëtorët dhe kreditorët, ndërmarrje shoqërore si dhe bartja e mjeteve të mbetura të buxheti i Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht, çfarëdo vonese në miratimin e këtyre ndryshimeve si në këtë projektligj ka efekt të drejtpërdrejtë edhe në ekonominë e vendit tonë, efekte të cilat do t'u referohem më gjerësisht në vijim.

Përfundimi i mandat ekzekutiv i EULEX-it në gjyqësor shënon njëkohësisht edhe momentum sa i përket fitimit të pronësisë së plotë në sistemin tonë gjyqësor.

Ky projektligj është një dëshmi konkrete se institucionet e Kosovës tashmë kanë kapacitetet dhe ekspertizën e nevojshme për të udhëhequr vetë dhe të pavarur punën në këtë gjykatë.

Me hyrje në fuqi të këtij projektligji vihen themelet e një strukture të re organizative brenda kësaj gjykate, e cila përveç se respekton pavarësinë e gjyqësorit, parasheh përfshirjen e plotë të kësaj gjykate brenda kornizës dhe kompetencave menaxhues të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.

Për të ilustruar më konkretisht këtë që sa e përmenda, në të gjitha çështjet e organizimit të brendshëm të gjykatës apo të emërimi të gjyqtarëve të kësaj gjykate, pa përjashtim, do të udhëhiqen ekskluzivisht nga rregullat e përcaktuara nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, çka nuk ka qenë e tillë deri më tani.

Jo më pak i rëndësishëm është fakti se përmes këtij projektligji Ministria e Drejtësisë njëkohësisht mendon të eliminojë gjendjen e rënduar që është krijuar si pasojë e numrit të madh të lëndëve të grumbulluara.

Aktualisht kjo gjykatë përmes grumbullimit dhe mospërmbylljes janë përafërisht 21 300 lëndë të regjistruara që mbajnë peng qindra miliona euro, para këto të punëtorëve që u takon 20%-shi, kreditorëve dhe, mbi të gjitha, të buxhetit të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu Avokati i Popullit ka lëshuar disa raporte me rekomandime lidhur me joefikasitetin e kësaj gjykate në trajtim në kohë të arsyeshme të ankesave dhe padive.

Është e papranueshme që për shkak të resurseve të pakta dhe të dinamikës së ulët të punës së kësaj gjykate, punëtorët dhe kreditorët të presin me vite të tëra për ta marrë hisen e tyre të ligjshme nga privatizimi i ndërmarrjeve, përmes ndryshimeve strukturore dhe organizative të pasqyruara në këtë projektligj janë ndërmarrë masa për zbatimin e parimeve të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për një gjykim brenda një intervali të arsyeshëm kohor.

Po ashtu përmes rishikimit të kompetencave dhe organizimit të brendshëm të Dhomës së Posaçme, projektligji në fjalë ofron zgjidhjen konkrete për rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies të kësaj gjykate, çka rezulton në zhbllokimin edhe të fondit të privatizimit.

Lehtësimi i procedurave para kësaj gjykate, shuarja e kolegjeve në kompetenca ekskluzive dhe heqja e numrit të përcaktuar të gjyqtarëve, janë disa nga ndryshimet strukturore, të cilat kanë si synim bazë rritjen e efikasitetit në zgjidhjen e kontesteve dhe reduktimin e ndjeshëm të numrit të lëndëve të grumbulluara.

Më konkretisht, përmes ndryshimeve të lartpërmendura synojmë që të përshpejtojmë procesin e përmbylljes së shpërndarjeve dhe likuidimin për kreditorët nga Fondi i Mirëbesimit, pra me qindra miliona euro, të cilat mbahen në llogarinë e BQK-së pa ndonjë dobi ekonomike për vendin tonë.

Shpërndarja e 20%-shit për punëtorët, të cilët shumica janë në moshë të shtyrë dhe presin me vite të tëra që ta realizojnë këtë të drejtë të tyre.

Shpërndarja për pagat e papaguara që janë pranuar me vendim të autoritetit të likuidimit për punëtorët, të cilët janë larguar nga puna në rast të futjes së ndërmarrjeve në likuidim.

Transferimi i mjeteve tepriçë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Shuarjen përfundimtare të ndërmarrjeve shoqërore pas likuidimit dhe njëkohësisht edhe përmbylljen e procesit të privatizimit.

Pra, hartimi i këtij projektligji është kryer në bashkëpunim të ngushtë me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilat kanë ofruar mbështetjen e tyre në hartimin dhe finalizimin e këtij projektligji.

Me theks të veçantë kanë qenë të përfshirë Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Gjykata Supreme si dhe përfaqësues edhe nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe Dhoma e Posaçme.

Gjatë gjithë fazës së hartimit dhe konsultimeve për këtë projektligj ne e kemi marrë parasysh dhe kemi shqyrtuar me kujdes të veçantë secilin nga alternativat e propozuara për funksionalizimin e plotë të kësaj gjykate dhe rritjen e efikasitetit llogaridhënës.

Shpeshherë është përfolur edhe kalimi i kësaj gjykate si një degë pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës, mirëpo një propozim i tillë, pas analizave të thella, ka rezultuar joproduktiv dhe i pamundur për zgjidhjen e situatës së rënduar.

Pra, së pari është e rëndësishme të theksohet se për hir të sigurisë juridike tashmë është vonë të eksperimentohet në këtë proces, tashmë kanë kaluar 16 vjet të procesit të privatizimit dhe ne e kemi një numër mjaft të vogël të ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë të likuiduara.

Shpërndarja e lëndëve nëpër gjykata themelore jo vetëm se do të stërngarkonte ato gjykata, të cilat veçse ballafaqohen me numër tejet të madh të lëndëve, mirëpo po ashtu do të stërzgjaste këtë proces dhe, në këtë mënyrë do të stërzgjaste edhe përfundimin e procesit të privatizimit.

Të nderuar deputetë,

Unë pa dyshim pres edhe propozime të tjera nga ana juaj në leximin e dytë, pres nga ana juaj që të ketë edhe propozime të tjera në riorganizimin e kësaj dhome, të dalim përtej kësaj që e ka propozuar Ministria e Drejtësisë, mirëpo ajo çka është e rëndësishme është zhbllokimi i këtyre mjeteve financiare dhe punëtorët që presin me vite të tëra këtë 20% të realizojnë këtë të drejtë të tyre. Faleminderit!

*(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)*

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Tahiri!

Fjalën e ka kryetarja e Komisionit Funkcional, zonja Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion në mbledhjen e mbajtur më 3.7.2018 e shqyrtoi Projektligjin numër 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në mbledhje të komisionit kemi pasur debate të shumta, ndoshta gati dy orë diskutime për këtë projektligj, por unë vetëm do ta lexoj rekomandimin e komisionit, pastaj anëtarët e tjerë edhe përmes kësaj seance do të mund t'i thonë qëndrimet e tyre.

Rekomandimi i komisionit është që të mos miratohet në parim Projektligji numër 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Pastaj në emër të grupit do të flas kur të më vijë radha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së është paraqitur zoti Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Qytetarë të dashur,  
Kryesues,  
Kolegë të nderuar,  
Ju ministra, mirë se na vini!

Më lejoni që fillimisht të shpreh ngushëllimet e thella për viktimat që kanë pësuar në vikendin e kaluar në komunikacion dhe bëj thirrje te qytetarë për kujdes të shtuar në rrugë tona, por njëkohësisht edhe te Ministria e Punëve të Brendshme që të ketë një plan konkret për përmirësimin e sigurisë në komunikacion dhe t'i zhvendosë përpjekjet nga vënia e gjobave në qendër të kryeqyteteve sa për ta mbushur buxhetin dhe t'i fokusojë përpjekjet që vërtet të përmirësohet kujdesi në komunikacion.

Më lejoni që tash të vazhdoj me temën që ka të bëjë me një projektligj, i cili adreson një organ institucional që është, si të themi, filtri i fundit për një proces që në vazhdimësi është kritikuar si proces i korruptuar, i kalbur dhe i njohur për procese të ndryshme me të meta të jashtëzakonshme.

Pra, po flasim për një institucion jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe mënyrën se si mund të adresojmë atë.

E kuptoj që është paraqitur shpesh sikur ky ligj ka të bëjë me heqjen e EULEX-it, është paraqitur si diçka kush është pro e kush është kundër EULEX-it, unë besoj një nga çështjet që i adreson është pikërisht kjo, në fakt më pak se një nen e adreson këtë çështje.

Ky projektligj ka të bëjë me diçka shumë më të madhe, po flas për një proces jashtëzakonisht të rëndësishëm dhe për një institucion që është, thashë edhe një herë, filtri i fundit.

Lidhur me këtë mund të flasim në dy aspekte: në aspektin politik dhe në aspektin juridik ose profesional.

Më lejoni të filloj me disa pika shumë shkurtimisht në aspektin politik.

Po flitet për përfundimin e mandatit të EULEX-it, po unë mund të flas edhe për vete, por edhe për shumicën prej jush që ne nuk e dimë çka është mandati i ri i EULEX-it.

Letrat e këmbimit të presidentit nuk na u kanë dhënë neve si deputetë dhe përkundër kërkesës së Komisionit për Legjislacion, edhe kryetarja mund ta konfirmojë këtë, nuk kemi marrë informata. Tash si mund ta adresojmë një prezencë ndërkombëtare në Kosovë kur nuk e dimë çka është



mandati i ri edhe a po e shkelim atë çka cilësohet si marrëveshje të nënshkruar nga presidenti me anë të këtij projektligji.

Çështja tjetër, a dëshirojmë të vazhdojmë nëpërmes këtij projektligji t'ia shtyjmë jetën tutje një legati të hidhur, pra një prezence të një Dhome të Posaçme në kuadër të Gjykatës Supreme, siç është adresuar që nga koha e UNMIK-ut, ka vazhduar pastaj edhe më tutje dhe po tentohet që të vazhdojë në avazin e njëjtë.

Sidoqoftë, këto janë çështje që në aspektin politik duhet të mendohen pak më mirë, para se të adresohet ligji.

Më lejoni të kthehem tash në kontekstin e dytë, pra po flasim për çështjen e dytë që ka të bëjë, e para ke politike, e dyta ishte profesionale ose juridike.

Dhoma e Posaçme me anë të këtij projektligji vazhdon të mbetet në funksionim në kuadër të Gjykatës Supreme.

Ka shkolla të të menduarit sa i përket mënyrës se si adresohet, disa, përfshirë këtu edhe Qeverinë, mendojnë se duhet të vazhdohet të jetë në kuadër të Gjykatës Supreme.

Unë mund të them se kam pasur biseda, me përjashtim të gjyqtarëve në Dhomën e Posaçme, kam pasur biseda edhe me gjyqtarët e Gjykatës Supreme, edhe ata të Apelit, edhe të themeloreve dhe shumë radhë ndodh t'i kesh të gjithë me një qëndrim të unifikuar dhe ky ishte ai rast kur ata thanë nuk ka vend kjo Dhomë e Posaçme në Gjykatën Supreme. Do të thotë shumë rrallë ndodh t'i kesh të gjitha nivelet e gjykatave të unifikuara sa i përket një qëndrimi dhe ky ishte ai, kur të gjithë thoshin: "Ju lutem, mos e leni më të vazhdojë në Gjykatën Supreme, po futeni në shkallë të parë diku, qoftë në gjykata themelore apo në kuadër të një Gjykate Themelore që është e Prishtinës, si departament i veçantë".

Prandaj, duhet menduar këtë çështje: a është qasja jonë korrekte për të vazhduar në mënyrën se si është adresuar deri më sot apo dëshirojmë të jemi pak më proaktivë në të menduar se si të adresojmë një çështje problematike.

Çështja e dytë që ka të bëjë me këtë projektligj është çështja e dyshkallshmërisë, pra në kuptim të nenit 32, a po zbatohet çështja e dyshkallshmërisë kur kemi brenda një organi me gjyqtarë të cilët i ndajnë zyrat afër njëri-tjetrit, kanë komunikim të përditshëm, a po zbatohet e drejta e qytetarëve për të pasur trajtim në dy shkallët e vendimeve të tyre. Pra, edhe kjo një çështje që vlen të mendohet.

Po ashtu sa i përket vendimmarrjes, unë kam dëgjuar që çështja është për ta përshpejtuar trajtimin e lëndëve dhe në një vend normal, në rrethana normale, e natyrshme është që në shkallë të parë do të ishte shpejtim i trajtimit të lëndëve sikur të reduktohej trajtimi i tyre nga tre gjyqtarë në një, po flas për vende normale. Mirëpo, a jemi ne duke funksionuar në rrethana normale? A e kemi privatizimin proces që mund të cilësohet si normal ose si proces i ligjshëm? A e kemi një gjyqësor që nuk është i ndikuar, do të thotë a duhet të vendosim vetëm diçka sa për sy e faqe, apo vërtet duhet të hartojmë projektligje bazuara në rrethana tona konkrete? Unë besoj, e të gjithë pajtohem që procesi i privatizimit nuk ka qenë normal, nuk ka qenë pa të meta, ka pasur shumë të meta, ka pasur shumë aludime për korrupsion.

Dhe, rrjedhimisht, të zvogëlohet vendimmarrja te një person, unë nuk besoj, edhe grupi ynë parlamentar nuk beson që është qasja e duhur. Ne duhet të jemi inovativ sa i përket mënyrës si mund ta përshpejtojmë trajtimin e lëndëve, po ka edhe mënyra të tjera, të shtohet numri i gjyqtarëve, për shembull, rritet edhe më shumë, bëhet digjitalizimi. Ka metoda të jashtëzakonshme, të cilat mund të arrijnë këtë qëllim pa e trajtuar këtë çështje, sepse po vendosim mes dy të këqijave. Pra, a vendosim për ndoshta trajtim më të ngadalshëm, po më 'fer', apo trajtim më të shpejtë, me mundësi të jashtëzakonshme të ndikimit të korrupsionit, e kështu me radhë. Sikur të zhvendosej në Gjykatën Themelore, atëherë do të eliminohej kjo vendimmarrje e dyshkallshmërisë brenda një organi, pse? Sepse Themeloria do të vendoste në shkallët të parë, Gjykata e Apelit do të vendoste në shkallë të dytë. Çështja tjetër që vlen të potencohet si ndryshim është heqja e kryetarit të Dhomës së Posaçme dhe tani kryetari i Gjykatës Supreme është njëkohësisht kryetar i tërës Supreme, përfshirë edhe këtë Dhomë të Posaçme. Ndërsa, Dhoma e Posaçme ka një gjyqtar mbikëqyrës.

Po ashtu, një problem që paraqitet në praktikë është fakti se deri më tani me këtë projektligj kriteri për emërim në këtë Dhomë të Posaçme barazohet me gjyqtarë, të cilët shërbejnë në Gjykatën Supreme, me përjashtim të disa kritereve shtesë që i kanë për shkak të natyrës së lëndëve. Çka ndodh tash është që do të ketë gjyqtarë të rinj që shkojnë aty dhe do të ketë gjyqtarë që janë emëruar aty, por që nuk i kanë pasur të njëjtat kritere të emërimit sikurse gjyqtarët e rinj dhe do të ketë dallim, edhe duhet të jetë e qartë si të adresohet ky dallim në mes të gjyqtarëve, të cilët shërbejnë në të njëjtën Dhomë.

Njëkohësisht, qëllimi i projektligjeve, të cilat shndërrohen në ligje nga ky Parlament, duhet të jetë që të thjeshtëzojnë procedurat, të bëhen ligje sa më të përdorueshme për qytetarët. Fatkeqësisht, edhe në këtë rast, po vazhdohet që ky ligj të përbëhet edhe nga aspekte materiale, por edhe nga aspekte procedurale. Do të thotë, qytetarët po detyrohen tash vetëm për këtë Dhomë të mësojnë procedura të reja, përderisa ne kemi Ligjin e Procedurës Kontestimore që me përjashtim të disa dispozitave shumë të thjeshta, mund të plotësohet për t'i adresuar edhe këto çështjet e Dhomës së Posaçme. Vazhdon pastaj të operojë si institucion i ndarë nga Gjykata Supreme, sepse edhe zyrën e regjistrimit do të thotë i lejohet ta ketë të ndarë nga Gjykata

Supreme. Po ashtu, një çështje shumë e rëndësishme është përderisa të gjitha procedurat lejohet mjeti i jashtëzakonshëm, shtrohet pyetja në këtë rast si do të bëhet kjo çështje? Në Ligjin e Procedurës Kontestimore nuk lejohet revizioni ndaj vendimeve të Gjykatës Supreme. Kështu që nëse ky është rasti, atëherë a e lejojmë revizion ndaj vetvetes apo ua mohojmë palëve mundësinë e përdorimit të mjeteve të jashtëzakonshme. Likuidimi, riorganizimi nuk janë adresuar sa duhet. Pastaj, problemet e tjera, të cilat e bëjnë këtë ligj, nuk e di sa kemi mundësi na t'i rregullojmë të gjitha këto probleme nëpërmes amendamenteve.

Nëse ne kemi nevojë ta rishkruajmë ligjin, atëherë a ia vlen të hyjmë në procedurë me këtë ligj, për ta rishkruar ligjin me 100-200 amendamente, sepse edhe ligji nuk është shumë i shkurtër. Tash, shtrohet pyetja në përfundim: a po dëshirojmë ta bëjmë një ligj të keq, ta adresojmë këtë çështje kaq të rëndësishme me një ligj të keq për hir të procedurave të përsheptuara? Apo, po dëshirojmë që t'i japim si legjislativ vëmendjen e kërkuar dhe të duhur kësaj çështje? S'po flas vetëm për ligjin, por çështjen e adresimit gjyqësor të lëndëve që vijnë si pasojë e privatizimit...

*(Ndërprerje nga regjia)*

KRYESUESI: Po, vazhdoja, ta përfundojë mendimin.

KORAB SEJDIU: Apo dëshirojmë të marrim kohën tonë të duhur për ta adresuar këtë çështje kaq të rëndësishme me një ligj që e meriton jo vetëm AKP-ja, sepse qasja në të kaluarën ka qenë pro e Dhomës së Posaçme, pro AKP-së, por në fakt, të adresohet ashtu siç e meritojnë qytetarët e këtij vendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hajdar Beqa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot ne po e shqyrtojmë një projektligj që është me rëndësi shumë të veçantë për infrastrukturën ligjore të Republikë së Kosovës. E inkurajoj ministrin e Drejtësisë, po edhe Qeverinë e Republikës së Kosovës për dinamikën e punës që po e bëjnë dhe përkushtimin që e kanë për reformën në sistemin e drejtësisë.

Ne realisht kemi diskutuar edhe në Komisionin për Legjislacion dhe kemi pasur një debat mbi dy orë, ku kemi pasur qëndrime të ndryshme pozitë-opozitë dhe në qëndrime 5 deputetë të pozitës kemi qenë për ta përkrahur ligjin, kurse opozita i ka pasur arsyet e veta pse të mos e përkrahur dhe kemi pasur një abstenim. Por, kur kemi hyrë në votim, kemi dalë me atë rezultatin që është

edhe në procesverbal, që e keni te Komisioni për Legjislacion. Ne duhet të mos i përziejmë çështjet, për arsye që po thonë privatizimi nuk po shkon mirë. Ky ligj nuk e ndal procesin e privatizimit. Ne e kemi zgjedhur edhe bordin, është një ligj tjetër, privatizimi ka vazhduar, ka valë edhe tash që është e hapur në Republikë të Kosovës në privatizim dhe duhet të dimë që ky ligj rregullon disa çështje të tjera që presin me padurim, janë mbi 22 mijë ankues ose ankesa që kanë të bëjnë kryesisht me punëtorët që kanë qenë në ndërmarrje shoqërore, kanë të bëjnë me pretendues të pronave që konsiderojnë që në kohë të caktuar ia kanë marrë sisteme të padrejta dhe pretendojnë që në prona të tyre dhe ne e dimë që kjo gjykatë, apo kjo Dhomë nuk e ka pasur një dinamikë dhe nuk ka treguar ndonjë sukses, por tash duhet ta kemi parasysh që nga 14 qershori kjo Dhomë nuk ekziston fare, sepse gjyqtarëve të EULEX-it që kanë qenë në Dhomën e Posaçme u ka përfunduar mandati.

Andaj, ne duhet ta bëjmë me çdo kusht funksionalizimin e kësaj Dhome, sepse janë shumë detyra që na presin, e tha edhe zoti Tahiri, duke filluar nga pritjet e ankuesve që presin me marrë 20%-shin nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore, kemi planifikuar në këtë buxhet të Republikë së Kosovës të kemi mjete që janë të parapara të kalojnë, që janë mjete tepriçë nga AKP-ja në buxhetin e Republikës së Kosovës. Kemi edhe shumë çështje të tjera që mendoj se ne duhet të angazhohemi, edhe pozita edhe opozita, që mes dy leximeve ato pretendimet që mendojmë që ky ligj nuk i rregullon mirë, të japim kontributin secili, sepse ne e ofruam në seancën e kaluar, ofroi mazhoranca të shkojë me procedurë të shpejtuar, megjithatë u bë një konsensus politik dhe ne vazhduam ku kemi mundësi sot ky ligj ka ardhur të kalojë vetëm në parim, kurse ne mund të japim kontributin tonë mes dy leximeve. Komisioni për Legjislacion e krijon grupin punues dhe në atë grup punues do të angazhohen edhe palët e tjera, duke i përfshirë edhe gjyqtarët, prokurorët, por edhe shoqëria civile që mund të japë kontributin dhe mendoj që nuk kemi kohë për të humbur, sepse duke humbur kohë në hartimin e ligjeve, ne po i ngadalësojmë edhe proceset integruese, edhe liberalizimin, andaj po i fajësojmë të tjerët pse s'po na ndihmojnë t'i kryejmë punët tona që janë obligim i institucioneve tona dhe neve si deputetë.

Në vijim dua t'i theksoj disa nga risitë që i thanë edhe kolegët, kolegu nga komisioni paraparakisht, në Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që ndërlidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, e që janë ndryshime përmes të cilave është ristrukturuar dhe forma e funksionimit të brendshëm të gjykatës, duke shuar kolegjin e specializuar në shkallë të parë dhe kalimin e kompetencave te një gjyqtar i vetëm. Ne e dimë që ka pasur kolegji, tash sponsoruesi ka menduar të jetë më efikas, të jetë te një gjyqtar i vetëm, por megjithatë ne mund të diskutojmë në grup punues dhe në komision mes dy leximeve, po edhe deputetët të japin kontributin e vet dhe ta gjejnë formën më të mirë, po të mos e ndalim procesin e ligjit, sepse e kemi atë Dhomë të pafunksionalizuar se i ka skaduar mandati. Po ashtu, në mënyrë që Dhoma e Posaçme të jetë në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit për gjykatat, është shuar pozita e kryetarit të Dhomës së Posaçme, duke ia kaluar ato kompetenca kryetarit të

Gjykatës Supreme dhe duke njohur pozitën e gjyqtarit mbikëqyrës të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, siç aplikohet në raste të tjera të degëve të gjykatave.

Do të thotë, nuk ka ndonjë risi, po njëjtë, qysh veprohet në raste të tjera, do të veprohet edhe këtu. Njëkohësisht është paraparë harmonizimi i plotë i organizimit të brendshëm me Rregulloret e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sidomos sa i përket përcaktimit të kompetencave të stafit mbështetës dhe atij menaxherial drejtues, si dhe administrativ dhe regjistrimit të lëndëve. Ne, pa dyshim duhet ta kemi parasysh që ndryshon edhe përbërja dhe funksionimi i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, kur ne e dimë që gjyqtarët në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nga viti 2000 që i kanë pasur ato përgjegjësi, edhe gjyqtarët e EULEX-it tash nuk janë më dhe ne duhet t'i gëzohemi faktit që institucionet tona kanë mundësi t'i marrim edhe t'i kryejnë detyrat, të kalojnë nga gjyqtarët e EULEX-it në gjyqtarë të Republikës së Kosovës.

Pasi ne jemi në shqyrtim në parim, unë kisha kërkuar edhe nga anëtarët e komisionit, por edhe nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që sot ta mbështesim në parim këtë ligj, kurse ta japim kontributin tonë mes dy leximeve, edhe përmes grupit punues dhe komisionit. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar Projektligjin që e ka sjellë Qeveria e Republikës së Kosovës për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme. Ne kemi pasur edhe rezerva, por në këtë fazë do ta përkrahim projektligjin e propozuar nga zoti Tahiri dhe në mes të dy leximeve do të japim kontributin tonë si deputetë dhe si grup parlamentar. Unë ju falënderoj dhe ju ftoj që ta mbështesim këtë ligj, në këtë fazë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit, zoti Beqa! Fjalën e ka zonja Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje.

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit edhe një herë!

Së pari, meqë është ministri i Drejtësisë këtu, unë do të doja të shpreh brengën e grupit parlamentar lidhur me neglizhencën apo moskokëçarjen e Qeverisë Haradinaj në raport me grevën e administratës gjyqësore. Ka ditë që administrata gjyqësore, diku rreth 2 mijë punëtorë janë në grevë për shkak të pagave të vogla, kërkojnë rregullimin e statusit të tyre dhe për ne është e papranueshme që Qeveria nuk lodhet në këtë drejtim.

Është e padrejtë që një punëtor i administratës gjyqësore, një bashkëpunëtor profesional t'i ketë 350-400 euro pagë, në anën tjetër të kemi gjyqtarë dhe prokurorë që e kanë 2 mijë euro pagën. Pra, është një mospërputhje e madhe ndërmjet tyre, duke marrë parasysh që janë të ngarkuar jashtëzakonisht shumë me punë. Andaj, ne kërkojmë nga Qeveria Haradinaj që të veprojë shumë shpejt në këtë drejtim. Natyrisht jemi për pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por po ashtu Qeveria duhet të ketë vëmendjen te administrata gjyqësore. Vetëm tani sa jemi në seancë jemi të njoftuar nga shumë qytetarë që po shkojnë nëpër gjykata për të marrë një certifikatë që s'janë në hetime për shkak që të aplikojnë për një vend pune dhe nuk po mund t'i kryejnë këto shërbime

për shkak të grevës dhe punëtorët nuk kanë faj këtu. Faj ka Qeveria Haradinaj për shkak të vendimeve të padrejta dhe të paligjshme për rritjen e pagave për vete deri në 100%.

Po vazhdoj me kritikën dhe qëndrimet tona në raport me projektligjin që e kemi para vetes. Së pari, meqë lidhet kjo çështje me mandatin e EULEX-it, nuk ka nevojë që ta them qëndrimin e Vetëvendosjes në raport me misionin e EULEX-it që ka qenë komplet një mision politik dhe komplet një mision i dështuar, por duke u bazuar edhe në seancën e kaluar, ku diskutuam për këtë projektligj, ne si grup parlamentar kemi kërkuar nga Zyra e Presidencës që të kemi qasje në letërkëmbimin ndërmjet Presidentit Hashim Thaçi dhe zonjës Frederika Mogerini për mandatin e EULEX-it dhe ende, sepse secili deputet ka të drejtë të qasjen në secilin dokument publik që nuk është konfidencial. Ne i kemi shkruar Zyrës së Presidencës dhe ende nuk kemi marrë letërkëmbimin që ka të bëjë me mandatin e EULEX-it.

Është e papranueshme për neve si subjekt politik që deputetët e Kuvendit të mos jenë në dijeni se cili do të jetë mandati i radhës i këtij misioni dhe është e papranueshme që tinëzisht presidenti Thaçi i bën këto veprime.

Projektligji që kemi para vetes ka defekte të shumta, duke filluar nga aspekti procedural e deri te përmbajtja e tij, në fakt, vetë qëllimi është problematik. Nëse lexohet ky projektligj nen për nen, vërejmë hapur se ata që e kanë shkruar që unë sot s'e di me saktësi se kush, a janë ekspertët evropianë, a amerikanë, a kush është, për shkak se ne kemi pasur takime me përfaqësues të sistemit të drejtësisë, e përmendi edhe zoti Korab Sejdiu në një vizitë që kemi qenë në Gjykatën Themelore dhe ata nuk e përkrahin këtë projektligj. Prandaj, këtu vërehet që ata që e kanë shkruar këtë draft kanë pasur për qëllim akomodimin e gjyqtarëve që do të merren me lëndët e AKP-së apo të vendimeve të padrejta të AKP-së, por jo edhe për palët. Dhe, për shkak të padrejtësive të mëdha të kësaj Dhome deri tani, është dashur të mendohet dhe të adresohen shqetësimet e punëtorëve dhe nuk është e rastësishme, sepse gjithnjë kemi pasur si me thënë averzion ndaj kësaj Dhome pikërisht për shkak të padrejtësive të mëdha të deritanishme.

Po filloj me neni 7, pika 1, ku thuhet se "kolegjiumi i gjyqtarëve mund të shpallë rregulla të tjera procedurale që i konsideron të domosdoshme". Së pari, ky formulim nuk ka asnjë kuptim, sepse aktet e tilla nuk mund të jenë në kompetencë të gjyqtarëve të përfshirë në gjykimin e rasteve, madje edhe mund të keqpërdoret me një dispozitë të tillë. Kjo bëhet shumë problematike sidomos kur kemi parasysh që me këtë ligj, sipas pikës 3, të nenit 9 panel mund të konsiderohet edhe vetëm një gjyqtar i vetëm. Neni 9 që rregullon aktgjykimet, aktvendimet dhe apelet është tërësisht jofunksional dhe nuk sjell drejtësi, por arbitraritet. Pra, e vazhdon arbitraritetin e deritanishëm.

Ky projektligj i diskriminon palët që kanë për të qenë subjekt i tij, për shkak se përcakton afate strikte për palët, por në anën tjetër, nuk jep afate për shqyrtimin e rasteve, duke lënë mundësinë

që rasti të zvarritet pa asnjë kufizim për gjyqtarët ose panelin e gjyqtarëve. Sot ka me qindra qytetarë që për vite radhazi presin drejtësi dhe mospërcaktimi i afateve kohore përbën shkelje të drejtave të tyre, madje edhe shkelje të Kushtetutës, sepse Kushtetuta konsideron që të gjithë duhet të kenë të drejtë në afat sa më të shpejtë drejtësi për një rast të cilin e konteston.

Pika 1 e nenit 9 përcakton afatin prej 15 ditësh, brenda të cilit afat gjykata duhet të japë aktgjykim, por në fakt nuk përcakton asnjë dinamikë të procedimit nga parashtrimi i një ankese apo rasti nga palët e deri te momenti i përfundimit të procedurave me shkrim dhe verbale. Kjo fazë e procedurës mund të zgjasë pa asnjë përkufizim kohor. Më tej paragrafi 2 i nenit 9 është goxha problematik, sepse thotë që shqyrtimet e brendshme të secilit kolegji në lidhje me një aktgjykim apo një aktvendim do të jenë të fshehta dhe nuk do të zbulohen. Kjo është goxha problematike, në qoftë se pala nuk e di se si vjen puna deri te një aktgjykim apo deri te një aktvendim, pra është goxha arbitrare dhe po ashtu kundërkushtetuese. Më tej një nga gjërat më problematike që ka ky projektligj ka të bëjë me shqyrtimin e lëndëve nga një gjyqtar i vetëm.

Pika 3 e nenit 9 thotë se “aktgjykimet dhe aktvendimet në shkallë të parë shqyrtohen dhe vendosen nga një gjyqtar i vetëm”. Është shumë e qartë që kjo rrit mundësinë e manipulimeve, shkeljes së të drejtave të palëve, por edhe mundësinë e korrupsionit, për shkak se këtu po flitet për miliona e miliarda euro, duke qenë se një gjyqtar është më lehtë i kontrollueshëm, më lehtë i manipulueshëm, madje edhe më lehtë i korruptueshëm. Dhe, duke marrë parasysh sistemin tonë të drejtësisë sigurisht që kjo paraqet probleme të mëdha dhe arsyetimi që kjo do të shqyrtojë apo do të përshpejtojë procedurat është i pabazuar, për faktin se vendosja e afateve strikte për shqyrtimin e lëndëve natyrisht që do të çonte në përshpejtim të shqyrtimit të lëndëve.

Pika 5 e nenit 9 është po aq problematike sa edhe pika 3, duke qenë se sërish rritet mundësia e arbitraritetit. Kjo pikë i jep mundësinë një gjyqtari të vetëm që të vendosë nëse një palë ka të drejtë për mjete juridike apo jo, merreni me mend. Pika e 11 e nenit 9 thotë se Kolegji i Apelit mund ta kthejë aktgjykimin apo aktvendimin në plotni apo pjesërisht te gjyqtari i vetëm apo kolegji përkatës, për procedim të mëtutjeshëm nëse paraqitet nevoja të ketë prova shtesë apo ripërtëritje të procedurave të vlerësimit të dëshmive. Kjo pikë presupozon se trajtimi i rastit nga gjyqtari nuk ka qenë i duhur, por potencialisht rikthen rastin tek i njëjti gjyqtar. Nuk janë të rralla rastet kur gjyqtarët në nivele të ndryshme të gjykatave të Kosovës gjykojnë të njëjtin rast dhe nuk ka ndonjë mbikëqyrje lidhur me ndryshimet e evidencave apo në qoftë se gjykimi ka qenë i ndryshëm nga shkalla e parë, apo jo?

Për më tepër mundësia që një lëndë që edhe ashtu nuk ka afatin për shqyrtim në shkallë të parë mund të rikthehet nga paneli i Apelit, gjë që mund të kthejë palën në një proces shumë të gjatë dhe të paparashikueshëm. Pastaj, problematikë është jashtëzakonisht shumë neni 10, paragrafi 3.2 që flet për mjetet juridike, gjegjësisht për kompensimin në vend të kthimit të pronës, unë veç po e lexoj se çfarë paraqet neni 10, pika 3.2.

Thuhet që ajo palë do të ketë të drejtë vetëm të kompensimit adekuat monetar për humbjen e të drejtës, titullit apo interesit të tillë. Madhësia e një kompensimi të tillë do të përcaktohet në bazë të vlerës së transaksionit të kryer nga AKM-ja apo AKP-ja tash, apo pasurisë në fjalë, derisa shkalla e kënaqshmërisë së atij kompensimi është subjekt i dispozitave në fuqi të Ligjit mbi AKP-në.

Pra, çfarë do të thotë kjo? Ta zëmë se dikush ka blerë dhjetëra hektarë tokë nga procesi i privatizimit me vetëm 30 euro. Dhe, çfarë ndodh? Në qoftë se pala shfrytëzon të drejtën për ta kontestuar këtë vendim të AKP-së, gjykata, Dhoma e Posaçme vendos se pala ka të drejtë, ndodh që AKP-ja ia kompenson pronën me vetëm 30 euro, aq sa e ka privatizuar. Kjo është skandaloze. Kjo madje është edhe kundër Kushtetutës së Republikës së Kosovës, gjegjësisht neni 119, paragrafi 1 dhe 3, ku specifikon që “Republika e Kosovës siguron mjedis të favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, lirinë e aktivitetit ekonomik dhe sigurinë e pronës publike dhe private, por po ashtu veprimet që kufizon konkurrencën e lirë në mes vendosjes apo abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që kufizojnë konkurrencën janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj”.

Pra, ne konsiderojmë që kjo, përveçse është arbitrare, është e padrejtë në favor të palëve, është po ashtu edhe kundër Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nëse më lejohet, zoti kryesues?

**KRYESUESI:** Përfundoje mendimin!

**ALBULENA HAXHIU:** Faleminderit!

Vetëm edhe dy-tre minuta. Është një pikë që veçanërisht tregon se ligji ose është shkruar shpejt, ose ka pasur për qëllim të kufizojë të drejtën e palëve, që kanë të bëjnë me Dhomën e Veçantë. Pika 14 e nenit 9 nuk i jep asnjë të drejtë palës që të vazhdojë të drejtën e vet në nivele të tjera gjyqësore, sepse thotë: “Të gjitha aktgjykimet dhe aktvendimet e Kolegjit të Apelit janë të prera dhe nuk i nënshtrohen asnjë apeli tjetër”. Ky nen qartësisht krijon një pasiguri juridike dhe është i orientuar kundër të drejtës së palëve, sepse nuk parasheh vazhdimin e mjeteve të tjera juridike përtej kësaj shkalle.

Domethënë, gjithashtu është problem që nuk specifikohet kush e bën vlerësimin e pronës. Nëse i mbetet Dhomës së Posaçme, kjo do të ketë probleme të mëdha. A do të ketë vlerësues të licencuar nga Ministria e Financave apo si qëndron puna, sepse është goxha problematike nëse e lëmë kështu siç është.

Në fund ne si grup parlamentar, duke pasur parasysh që procesi i privatizimit në Kosovë ka shkatërruar prodhimin, po ashtu edhe industrinë dhe po ashtu, nga ky procesi i privatizimit



neoliberal janë larguar nga puna mbi 76 mijë punëtorë, ne nuk mendojmë që ky projektligj është zgjidhje për t'i adresuar problemet në raport me privatizimin. Përkundrazi, vetëm sa do të konfirmojë vendimet e padrejta të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Ne si grup parlamentar po ashtu konsiderojmë që ajo çfarë do të duhej të bëhej është që Gjykata Themelore në shkallë të parë do të mund të autorizohet edhe me ligj që të trajtojë këto raste, ndoshta edhe një departament përbrenda Gjykatës Themelore, në mënyrë që palët ta ndjekin shkallën e parë, të dytën, por edhe të tretën për mbrojtje të ligjshmërisë që është Gjykata Supreme. Kjo është kërkesë edhe në takimet që kemi pasur, e përmendi edhe zoti Sejdiu, në Gjykatën Themelore dhe, natyrisht që ne si grup parlamentar nuk do ta përkrahim këtë projektligj, por më lejoni të them se është qëndrim i grupit parlamentar që të mos përkrahim apo të mos marrim pjesë në asnjë projektligj që procedohet nga kjo Qeveri. Meqë po deklaroni se e keni shumicën, urdhëroni, provojeni, ne nuk do të bëhemi pjesë e kësaj krahure. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Frashër Krasniqi e ka fjalën.

**FRASHËR KRASNIQI:** Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ka pak njerëz në Republikën tonë, duke përfshirë edhe këtë Kuvend, duke përfshirë pozitë e opozitë, që mendojnë se procesi i privatizimit në Kosovë është zhvilluar në mënyrë të rregullt, pa keqpërdorime dhe ka pasur rezultate të mira për ekonominë e Kosovës. Ndërkohë, ka pothuajse një konsensus shoqëror dhe politik që procesi i privatizimit është një prej arsyeve pse e kemi këtë gjendje kaq të rëndë ekonomike në Kosovë, pa prodhim vendor, pa industri, praktikisht me ekonomi të importit dhe komplet të tregtisë.

Si rrjedhojë, nëse e kemi një proces kaq të komprometuar, normalisht që për privatizimin do të ketë shumë ankesa dhe ka pasur shumë ankesa, ka pasur shumë padi nëpër gjykata dhe jorastësisht e kemi një Dhomë të Veçantë, e cila i ka diku rreth 21 000 lëndë të patrajtuara. Kjo i bie që jemi duke folur për një proces shumë të rëndësishëm, që ka rëndësi të madhe në ekonomi, ku janë shkelur shumë të drejta, ku janë shkelur shumë ligje dhe për këtë proces vendoset në një gjykatë, për të cilën po diskutojmë sot. Është e pashpjegueshme për Partinë Socialdemokrate, siç po duket edhe për shumë deputetë të tjerë, se si është e mundur që procese kaq të rëndësishme, institucione kaq të rëndësishme, na vijnë për diskutime në Kuvend në mënyrë të jashtëzakonshme dhe në mënyrë të përsheptuar. Pse nuk është hapur diskutimi mbi çështjen e Dhomës së Posaçme më herët, edhe para se t'i kalojë mandati EULEX-it? Pse nuk është hapur një diskutim shoqëror, edhe nëse nuk ka mundur për arsye ligjore ministria të propozojë ligje, ka mundur të hapet debati shoqëror me shoqërinë civile, me ne deputetët dhe me u thënë të gjitha këto mendime para se të përpilohet ligji, sepse jemi duke e ndërtuar një shtet ad-hoc. Nuk ndërtohet shteti ad hoc! Nuk ndërtohet shteti duke krijuar vazhdimisht situata të jashtëzakonshme

dhe duke na sjellë para një akti të kryer që ose duhet ta zgjidhim brenda dhjetë ditëve, ose do të kolapsojë një segment i sistemit shtetëror, qoftë i drejtësisë, qoftë ndonjë segment tjetër.

Kjo situatë po na shtyn pastaj të miratojmë ligje, të cilat normalisht që nuk po e zgjidhin problemin. Për shembull, do të ishte shumë e rrugës që para se të na vini me një ligj për Dhomat e Posaçme, ta kishim një raport të Dhomës së Posaçme, çfarë ka bërë deri tash, ta dimë a ka funksionuar kjo Dhomë. Pse kanë mbetur 20 000 lëndë të pazgjidhura? Do të ishte mirë ne deputetët ta shohim nëse nuk ka funksionuar, pse s'ka funksionuar? Nëse ka funksionuar mirë, pse ka funksionuar mirë dhe të gjitha këto t'i përfshinim në ligjin e ri. Ne nuk e kemi, përveç faktit që kjo Dhomë e Posaçme nuk i ka zgjidhur 20 000 lëndë, nuk kemi ndonjë statistikë tjetër dhe nëse nisemi nga ky fakt, atëherë ka probleme. Pse duhet t'ia vazhdojmë mandatin një Dhome të Posaçme, e cila s'paska qenë efikase, sepse po thuhet që kemi nevojë të ndërmarim masa, ta vazhdojmë mandatin e Dhomës së Posaçme për shkak se ka shumë lëndë të pazgjidhura dhe na duhet efikasitet për ta liruar fondin e privatizimit, për t'ia liruar fondet për punëtorët, 20%-shin, e tjerë, e tjerë. Mirëpo, cila është logjika që do të rritet ky efikasitet me të njëjtën trupë gjyquese, pak a shumë me të njëjtin rregullim të kësaj trupe gjyquese.

Me të gjithë ekspertët, se ministri e di që u është referuar edhe diskutimeve me ekspertë dhe gjykatës, mirëpo me të gjithë ekspertët ligjorë që kam pasur rastin të takohem unë gjatë kësaj jave, jo vetëm unë, edhe deputetë të tjerë të Partisë Socialdemokrate, asnjë prej tyre nuk është dakord me këtë projektligj. Unë nuk di cilët ekspertë i ka takuar tash ministri! Mirëpo, ekspertë të cilët i kam takuar unë, ndoshta as ata nuk janë adekuatë, nuk e di, por ata që i njoh e i kam takuar, nuk janë dakord me këtë ligj dhe janë disa arsye pse s'janë dakord, e për të cilat do të flas më tutje.

Reduktimi fillimisht i trupave gjyquese në një gjykatës të vetëm në shkallën themelore të kësaj Dhome është problematik, sepse, nën 1, lë hapësirë për keqpërdorime, në rastin më të keq, po hajde që po i heqim keqpërdorimet, po supozojmë që nuk do të ketë keqpërdorime, në rastin tjetër më të mirë ka hapësirë për vendime joprofesionale. Nuk mund t'ia lëmë procesin gjyqësor veç një gjykatësi, nëse është fjala, ta zëmë, për 20 milionë euro të kontestuara, po supozoj. Qysh mund të vendosë veç një gjykatës? Ne e dimë që arsyeja pse në sistemin tonë gjyqësor procedohet me trupa gjyquese është për shkak se vendimet që merren prej një trupe, prej tre ose pesë anëtarësh, janë më cilësore se sa vendimet që merren prej një gjykatësi. E ne nuk mund të lëmë vendime ose raste ku kontestohen shuma të mëdha dhe janë shumë të komplikuar, në dorë të vetëm një gjykatësi.

Kështu që, normalisht që ne nuk jemi dakord në lexim të parë të këtij ligji, por nëse kalon, në lexim të dytë ne do të propozojmë që këtu së paku të vihet një limit. Rastet të cilat kanë vlerë më të vogël, e bëjmë një prag, në konsultime edhe me ekspertë, mund të trajtohen prej një gjykatësi,

për rastet me vlerë më të madhe, për hir të efikasitetit, rastet në vlerë më të madhe duhet të trajtohen prej kolegjeve gjyqësore.

Pastaj, është mungesa e dyshkallshmërisë. Kjo është shkelje flagrante edhe e të drejtave të njeriut, po edhe e mënyrës se si është e rregulluar drejtësia në shtetin tonë. Jorastësisht e kemi të ndarë Gjykatën Themelore prej Gjykatës së Apelit dhe pastaj Gjykatës Supreme, sepse një qytetar i Republikës së Kosovës duhet t'i konsumojë, duhet ta ketë të drejtën për t'u ankuar diku. Qysh është e rregulluar Dhoma e Posaçme, një qytetar i cili ka ankesë ndaj vendimit të shkallës së parë të kësaj Dhome të Posaçme, i bie të ankohet prapë brenda Dhomës së Posaçme, sepse edhe Kolegjin e Apelit e zgjedh i njëjti kryetar, i cili i cakton lëndët në nivelin themelor. Kjo është, përveç mundësi për keqpërdorime, sepse kontrollohet prej një trupi të vetëm, është edhe shkelje e të drejtës së ankesës.

Si do të rregullohej kjo çështje? Unë mendoj që fillimisht duhet të çlirohemi nga ideja e rregullimit të çështjeve ad-hoc dhe në mënyrë urgjente. Ta shtrojmë çështjen në nivel afatgjatë, jo veç hajt shkel e shkel ta kryejmë këtë punë, në mënyrë që të kemi mbulesë ligjore për ta vazhduar një dhomë të posaçme, për të cilën nuk e dimë as çfarë suksesi ka pasur. Krejt çfarë dimë për të është se janë 20 000 lëndë të pazgjidhura. Krejt çfarë dimë për të është se ka pasur keqpërdorime shumë të mëdha prej privatizimit. Krejt çfarë dimë është se ka ankesa shumë të mëdha, ka shumë-shumë protesta, për të mos thënë më së shumti protesta që janë bërë në këtë vend, të vogla e të mëdha, janë bërë kundër privatizimit. Kështu që kjo gjykatë patjetër që ka marrë pjesë në këto vendime të gabuara, sepse përndryshe do të kishim një kënaqshmëri më të madhe të qytetarëve, se edhe nëse do të ishte bërë ndonjë shkelje në privatizim, gjykata do ta rregullonte dhe qytetarët do të ishin më të kënaqur. Po, ne e dimë që ka pakënaqësi të madhe për këtë punë.

Zgjidhja për këtë çështje, zgjidhja më e mirë e propozuar edhe prej ekspertëve, është që kjo gjykatë, ose kjo Dhomë e Veçantë të bëhet departament i veçantë në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit, pra në përgjithësi në sistemin e drejtësisë në Kosovë. Ne kemi departament të veçantë për çështjet administrative, kemi departament të veçantë për çështjet ekonomike në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit, kemi departament për çështjet penale, për çështjet civile, e kështu me radhë, pse të mos e bëjmë edhe një departament të veçantë për çështjet e AKP-së në nivel të Gjykatës Themelore, në nivel të Gjykatës së Apelit, ku do të përfshiheshin të njëjtit gjykatës, pasi që po themi se ata janë të specializuar në këtë çështje dhe ku do të mund të shtonim edhe gjykatës të tjerë, shtesë, qoftë në nivel themelor, qoftë në nivel të apelit.

Kjo do ta zgjidhte edhe çështjen e mungesës së dyshkallshmërisë, që e trajtova më herët dhe kjo çështje, kjo zgjidhje, do të mund ta zgjidhte problemin në nivel afatgjatë, pa e humbur efikasitetin. E di se do të thuhet që kjo përfshirje, ose ky rirregullim i Dhomës së Posaçme mund ta vonojë shumë procesin e zgjidhjes së lëndëve, por unë nuk jam i sigurt se kjo është e vërtetë,

sepse unë nuk po them që këto lëndë të kthehen te gjykatësit e thjeshtë, pra të procedurave të rregullta, qoftë civile, qoftë administrative, por unë po them që të krijohet departament i veçantë. Kjo mund të bëhet. Normalisht, merr pak më shumë kohë se sa të miratohet ky ligj, merr disa muaj më shumë, mirëpo mendoj se zgjidhet çështja në mënyrën e duhur dhe zgjidhet çështja pa u cenuar të drejtat e qytetarëve.

Konsideroj që efikasiteti në sistemin e drejtësisë, e veçanërisht në çështjet që lidhen me privatizimin, është shumë i rëndësishëm për shtetin e Kosovës, për të gjithë ata punëtorë, për të gjithë ata qytetarë që presin, mirëpo nuk duhet ta cenojmë drejtësinë për hir të efikasitetit. Është shumë e rëndësishme që drejtësia të jetë primare dhe të kombinohet me efikasitetin, se edhe mungesa e efikasitetit është një lloj padrejtësie në vete pastaj, sepse e dimë që rastet kur drejtësia vonohet, faktikisht nuk është drejtësi, mirëpo duhet të kombinohen këto të dyja. Nuk mund të kemi efikasitet si cenim të drejtësisë, duhet të kemi drejtësi dhe efikasitet, të dyja në të njëjtën kohë dhe për këtë ta gjejmë një zgjidhje. Prandaj konsiderojmë, me gjithë vullnetin tonë që kjo çështje të zgjidhet, me gjithë vullnetin tonë që të rritet efikasiteti në zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me privatizimin, ne jemi të detyruar që këtë projektligj të mos e votojmë për dhe jemi të hapur të diskutojmë, edhe me ministrinë, edhe me subjektet e tjera për ta gjetur një zgjidhje më të mirë për këtë çështje. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Shkumbin Demaliaj e ka fjalën.

**SHKUMBIN DEMALIAJ:** Faleminderit, kryesues!

Ministra,

Ministër i Drejtësisë, faleminderit që je këtu dhe besoj që edhe gjatë shqyrtimit do të ndihmosh në ato çka po diskutohet deri tash lidhur me këtë projektligj që sot e kemi në shqyrtim në parim.

Elementet e gjithë asaj që u diskutua nga kolegët deri më tash veç kanë marrë një epilog në trajtimin kur e kemi bërë kërkesën për shqyrtim të jashtëzakonshëm të këtij projektligji këtu në Kuvend dhe jemi marrë vesh pozitë dhe opozitë që të shkohet në procedim të rregullt. Paska qenë e arsyeshme kërkesa që të mos diskutohet në mënyrë të jashtëzakonshme. Po shihet se këta elementë opozitarë janë vetëm bardh e zi dhe kundër në gjithçka që sjell kjo Qeveri dhe vjen në Kuvend. Jemi marrë vesh që me këtë datë të shqyrtohet ky projektligj dhe të procedojmë tutje, derisa të rregullohet.

Sot patëm rastin të bisedojmë për grevat e punëtorëve të administratës. Sot ju pëlqeu pse duhet t'u rriten rrogat gjykatave, janë për, por janë kundër aprovimit të ligjit. E dimë se këtu kemi bërë një ligj, që përpos një bashkëpunëtori jo, por edhe dy bashkëpunëtorë profesionalë prej fillimit të vitit të ardhshëm do t'i ketë secili gjyqtar dhe prokuror. Kjo Qeveri ua ka mundësuar atë. Edhe rritje të pagave, të gjithë e dimë, ata që dinë çka është jeta institucionale dhe ligjore, nuk mund të ketë në korrik ose në shtator, Ligjin për nivelimin e pagave e kemi këtu, do ta shqyrtojmë dhe

sigurisht se do të ketë rritje të pagave për vitin e ardhshëm me aprovimin e buxhetit, nëse kanë disponim edhe opozita në këtë rast, se ne nuk do t'i pyesim, por do të vazhdojmë me këtë. Do të ketë rritje pagash në gjithë nivelin e administratës publike për vitin 2019.

Te Ligji për Dhomën Speciale me Gjykatë Supreme që ndërlidhet me AKP-në. Nuk jemi duke ndërtuar një ligj të ri prej fillimit, që po mendojmë se, desha unë a s'desha, jeta institucionale në Kosovë nuk ndërlidhet me atë se kur unë merrem me politikë. Kjo gjykatë, kjo Dhomë, ka ekzistuar që nga UNMIK-u, EULEX-i dhe tani. Dhe, pikërisht për shkak të përfundimit të një misioni ndërkombëtar, ne e kemi pak me nguti aprovimin e këtij projektligji, për shkak se po flasim që jemi ekspertë, jemi njerëz që i dimë të gjitha këto rrethana dhe po dëshirojmë ato përgjegjësi t' i marrim vetë.

Lidhur me këtë çështje, kur po dalin e po flasin kolegët, po flasin thuajse procesi i privatizimit ka qenë vetëm një valë dhe janë akumuluar të gjitha ato lëndë. Dihet sa valë privatizimi kanë qenë në Kosovë deri në këtë vit. Ka akumulim lëndësh, flasin për numrin e madh të lëndëve, 21 300 që janë në këtë Dhomë të Posaçme, por tash dëshirojmë të flasim, se aq të mençëm jemi sa t'i kthejmë dhe t'i shqyrtojmë në shkallshmëri, duke filluar prej gjykatave themelore e deri te ajo më e larta, për shkak se shkallshmëria këtu nuk mund të ekzistojë, për shkak se elementi i përfshirjes monetare financiare në secilën ankesë që mund të shkojë në këtë gjykatë nuk e lejon që gjykatat, flasin për 20 milionë, për 20 milionë të bisedohet në gjykatën e shkallës së parë. Ne e kemi të rregulluar me legjislacion edhe lartësinë monetare, cilat gjykata kanë të drejtën t'i shqyrtojnë ato.

Kjo Dhomë duhet të rregullohet në mënyrën më të mirë. Nëse këta kolegët e mi në këtë rast kanë ekspertë kaq të mëdhenj, që ekspertët e tyre u paskan thënë se kjo nuk është në rregull, ata ekspertë kisha dëshiruar t'i bien në grupe punuese në Komisionin tonë për Legjislacion dhe të trajtojmë gjatë leximit të dytë këtë projektligj. Por dijeni, kolegë të nderuar, se këta ekspertë s'do të vijnë kurrë, po e kemi për publikun, se mos po na del ndonjë votë, por humbin votat, se njerëzit që janë duke pritur t'u trajtohen lëndët, ata janë duke humbur më së shumti, 21 300 raste. Edhe këta flasin, e përkrahim e s'e përkrahim. Ka edhe raste të tjera.

Fatkeqësisht, te shkallshmëria dhe mënyra e ankesës dhe promovimi, në këtë rast, i mjeteve të jashtëzakonshme juridike, kur flasim në këtë rast ne e dimë se nuk jemi subjekt i të së drejtës ndërkombëtare për të mundur në ndonjërin nga gjykatat evropiane, në këtë rast, për të arritur formën e kontestimit dhe ndonjë mjeti, në këtë rast mjeti të jashtëzakonshëm juridik për të mundur të ankohemi. Mirëpo, deri tash askush nuk është ankuar. Vetëm janë ankuar se ka akumulim të lëndëve. Tash, kur po fillojmë për t'i zgjidhur, dëshirojmë ta bllokojmë. Të gjithë jemi ankuar për procesin e privatizimit, mirëpo bllokimi nuk është zgjidhje. Nuk është zgjidhje për ata njerëz që sot presin, se kanë punuar me nga 40 vjet dhe presin të përfitojnë nga ky proces,

kurse ne po ua vështirësojmë edhe pleqërinë, edhe mundësinë e përfitimit të atyre mjeteve që kanë derdhur djersën e tyre.

Folën kolegët më herët, se ka edhe raste të tjera, kjo gjykatë nuk i zgjidh vetëm rastet monetare apo format e tjera, që kanë ndodhur në procesin e privatizimit, mirëpo si Aleancë, si grup parlamentar personalisht i ftoj të gjithë deputetët t'i japim rrugë këtij projektligji dhe bashkë me ministrinë, si sponsorizues në këtë rast dhe Qeverinë e Kosovës, por edhe ata ekspertë të opozitës, edhe ne e dimë se ata që do ta ekzekutojnë këtë ligj, do t'i kemi të pranishëm, duke i përfshirë nga Këshilli Prokurorial, Këshilli Gjyqësor, gjykatat, të gjitha shkallshmëritë, bashkë me ta i kemi punuar të gjitha këto projektligje që lidhen me sistemin e drejtësisë, besoj se shumë shpejt do ta kemi edhe këtë projektligj të harmonizuar.

Që ndryshon diçka në të ardhmen, dera e Parlamentit s'do të mbyllet asnjëherë, kemi mundësi të bëjmë plotësim-ndryshime për ato që nevojiten në rrethana të caktuara në të ardhmen, sepse mund ta ndërrojmë edhe subjektivitetin, të jemi më të integruar dhe t'i trajtojmë edhe çështjet e pronësisë.

E përkrahim projektligjin, presim që gjatë trajtimit më tutje të japim kontributin tonë profesional si Aleancë. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar Nisma, Bilall Sherifi e ka fjalën.

**BILALL SHERIFI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Po nga ajo që është zhvilluar deri më tani lidhur me këtë projektligj shihet që kemi dallime të thella mes, ta quaj ashtu, dy-tri grupimeve politike.

Përderisa mazhoranca e mbështet ligjin për faktin se vjen nga ministri i Qeverisë, kemi pozicionime të ndryshme nga partitë opozitare, në njërën anë dhe nga Lista serbe, në anën tjetër.

Përderisa Lista serbe mohon të votojë, të përfshihet në këtë ligj për faktin se po përfundon mandati i EULEX-it, në anën tjetër kemi shqetësimet e partive opozitare që kanë natyrë tjetër dhe që për mendimin tim ato janë përmbajtjesore dhe si të tilla meritojnë nga ministri, në rend të parë, si sponsorizues i ligjit dhe nga ne kolegët e mazhorancës që t'i dëgjojmë dhe së bashku të vijmë në përfundime të përbashkëta nëse dëshirojmë ta kalojmë këtë ligj. Sepse matematika këtu është e thjeshtë.

Në opozitë janë 57 deputetë, të cilët po e kundërshtojnë këtë projektligj. Mazhoranca, përfshirë Listën serbe janë 61, minus 10 që nuk e mbështesin ligjin, janë 51. Pra, 57 e kundërshtojnë ligjin, si të tillë, 51 e mbështesin, ne mund të shkojmë në grupe punuese, mund të shkojmë në lexim të parë, lexim të dytë, por ligji, ministër, nuk kalon, po shihet, numrat janë kështu.

Pra, nëse dëshirojmë dhe unë besoj që të gjithë po dëshirojmë, jemi së paku deklarativisht për që kjo çështje të rregullohet me ligj, së pari ju, e pastaj edhe ne si pjesë e mazhorancës të ulemi dhe t'i dëgjojmë vërejtjet, këshillat, propozimet e opozitës, dhe jo të ecim në këtë mënyrë, e kemi sjell ligjin, thoni ju çka keni për të thënë, dhe ecim pastaj, vijmë, votojmë nuk e kaluam, punë e madhe.

Nuk do të kisha pasur dëshirë që ky ligj të trajtohet dhe të shihet vetëm ta quaj ashtu në rrafshin procedural, ku e sjellim, japim mendimet tona, shkojmë në komision, kthehemi edhe një herë, e amendamentojmë, s'e amendamentojmë, i nxjerrim votat dhe dështon ligji. Jo, sepse njerëzit të cilët janë të përfshirë në ato 21 mijë raste të pazgjidhura presin zgjidhje nga ky Kuvend. Meqë ata presin zgjidhje nga ky Kuvend, ne duhet të ulemi të bisedojmë se si ta bëjmë një ligj të përbashkët. Emëruesi i përbashkët i të gjitha partive politike, pozitë opozitë, në këtë rast, është se kjo çështje duhet të rregullohet, ky ligj duhet të bëhet, por të bëhet ashtu siç, pak a shumë do të mund të përfshiheshin pikëpamjet dhe këndvështrimet e të gjitha partive, për të cilat është e nevojshme vota e tyre në Kuvend.

Nisma i ka shqetësimet e veta, do t'i ketë edhe propozimet e veta gjatë procesit të shqyrtimit mes dy leximeve gjatë grupit punues, sepse besoj që do të krijojmë një grup punues në komision, por mendoj që duhet të punojmë më intensivisht, duke pasur parasysh faktin se jemi marrë vesh që brenda korrikut ta përfundojmë këtë ligj dhe të mos vazhdojmë në këtë lloj loje: nëse doni votoni, po nëse nuk doni, mos e votoni, ne nuk lëvizim nga pozicionet. Ka hapësirë, mendoj që ka hapësirë edhe me LDK-në, edhe me VV-në, edhe me PSD-në të bisedojmë, zoti ministër, dhe të gjejmë një solucion, një zgjidhje të përbashkët.

Por ka dilemat, për shembull, se a mund ta lëmë në duart e një gjykatësi një çështje të rëndë në emër të efikasitetit, një rast më të komplikuar në emër të efikasitetit apo nuk duhet është një dilemë që duhet dhënë përgjigje, se ligjet bëhen pak a shumë edhe duke pasur parasysh kontekstin dhe duke pasur parasysh vendin edhe duke pasur parasysh çështjet, të cilat do t'i trajtojmë. Çështje, për të cilat ai ligj do të hyjë në fuqi.

Pra, në lexim të parë në këtë rast i japim mbështetje këtij ligji, por mbajmë të drejtën që në lexim të dytë, nëse nuk arrijmë të harmonizohemi pozitë opozitë, që të bëjmë një ligj të përbashkët, të mos jetë ligj i mazhorancës, por ligj i Kosovës, i cili do të trajtojë dhe do të adresojë rastet e njerëzve, sepse ato për dikë mund të jenë numra, 21 mijë, por besoni që prapa atyre shifrave janë njerëz me halle, janë njerëz me nevoja, janë njerëz me të drejta.

Le t'i shohim 21 mijë raste si 21 mijë nevoja të njerëzve, ku përfshihen jo 21 mijë, po ndoshta 100 mijë njerëz, 100 mijë njerëz, të cilët në këtë vend presin drejtësi dhe ne duhet të bëjmë një ligj, përmes të cilit do të krijojmë mekanizma që atyre përpos shpejtësi, do t'u ofrojë edhe drejtësi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kinolli e ka fjalën.

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Kolegë deputetë,

Më lejoni që në emër të Grupit Parlamentar 6+ të jap mendimin dhe qëndrimin tonë në lidhje me Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në faqen 6.8 të memorandumit shpjegues të projektligjit shënon se gjatë hartimit të këtij projektligji janë shqyrtuar dhe inkorporuar propozime të arsyeshme të aktorëve relevantë.

Ndërkaq në pikën vijuese, pika 9 po të këtij memorandumit shpjegues, thotë se gjatë hartimit janë konsultuar aktorët relevantë të drejtësisë.

Nëse gjatë hartimit të këtij projektligji janë konsultuar aktorët relevantë, a ka të bëjë vetëm me aktorët e drejtësisë, apo mund të ishte e udhës të merreshin mendimet dhe qëndrimet e aktorëve tjerë, të cilët do të mund të kontribuonin në hartimin më të përshtatshëm të këtij projektligji?

Në nenin 4, paragrafi 9 thotë: “Të gjitha lëndët në shkallë të parë gjykohen dhe shqyrtohen nga një gjyqtar i vetëm”, ndërsa në vazhdim thotë se “përjashtimisht në rastet e ndërlikuara të kërkesave pronësore gjyqtari mbikëqyrës i Gjykatës Supreme me urdhër mund të përcaktojë një koleg prej tre gjyqtarëve për të gjykuar rastin.

Të nderuar,

Vetë leximi i këtij projektligji ka të bëjë me Dhomën e Posaçme, pra i bie specifike dhe, si e tillë duhet të trajtohet me kujdes maksimal.

Ndërkaq në nenin e lartcekur ka mangësi me esencën e këtij projektligji, sepse të gjitha lëndët, të cilat adresohen, gjykohen në Dhomën e Posaçme dhe kanë karakterin e veçantë të posaçëm dhe, si i tillë mendojmë se të gjitha lëndët duhet të trajtohen në kolegje gjyqësore për të ardhur deri të një vendim më profesional, sepse vendimet kolegjiale si të tilla mund të jenë me më pak gabime, duke qenë se merren mendimet e tre apo më tepër profesionistëve në këtë lëmi.

Po ashtu edhe caktimi i kolegjit nuk duhet të lihet në diskrecion të gjyqtarit mbikëqyrës të gjykatës, por kjo duhet të specifikohet me dispozita përkatëse se kur duhet dhe kur nuk duhet caktuar kolegji.



Në nenin 13, paragrafi 3 ka të bëjë me përjashtimin e gjyqtarit, ku ceket “se gjyqtari do të ketë detyrë absolute të kërkojë përjashtimin nëse paraqitet ndonjë pengesë prej kushteve të përcaktuara nga paragrafi 2 i këtij neni”.

Në procedura të tjera, penale apo civile kontestimore, për përjashtimin e gjyqtarit është i paraparë rregulli se gjyqtari nëse vëren ndonjë pengesë për gjykimin e çështjes sipas detyrës zyrtare, ai kërkon përjashtimin nga gjykimi, por edhe palët e gëzojnë të drejtën ligjore me një arsyetim të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit nga procedura gjyqësore nëse ekziston ndonjë pengesë ligjore.

Në nenin 14, paragrafi 3, thotë se “çdo person mund të konsultojë Zyrën e regjistrimit dhe të marrë kopje të ekstrakteve të regjistrit”.

Ne mendojmë se këtu çdo person, apo personat që kanë autorizim ligjor mund të kenë qasje në ekstraktet e Zyrës së regjistrimit.

Neni 32, paragrafi 2, thotë se “personat fizikë mund të përfaqësojnë vetveten”.

Të nderuar,

Ne jemi duke biseduar për një Dhomë të Posaçme dhe ashtu sikur që e cekëm më lart, në këtë Dhomë të gjitha lëndët do të jenë të kualifikuara dhe, si e tillë, ne mendojmë se çdo person fizik nuk mund të përfaqësojë vetveten, sepse ndodh që në procedurë gjyqësore në këtë Dhomë të jetë një person fizik, i cili është laik në aspektin ligjor. Duhet të inkorporohet një paragraf, me anë të të cilit i obligon që palët në procedurë obligohen të kenë një profesionist ligjor, konkretisht një avokat.

Çështja që na preokupon më së shumti në këtë projektligj ka të bëjë me nenin 4, paragrafi 2, ku flitet për përbërjen, organizimin dhe emërimin e kësaj Dhome të Posaçme, konkretisht thotë Dhoma e Posaçme përbëhet nga gjyqtarë shtetas të Republikës së Kosovës dhe pasqyron përbërjen etnike të popullsisë së Kosovës, ku së paku një gjyqtar vjen nga radhët e komuniteteve që nuk është shumicë në Republikën e Kosovës.

Të nderuar,

Ligji aktual, konkretisht Ligji numër 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në kreun 2, tek përbërja dhe organizimi i Dhomës së Posaçme, në nenin 3 tek përbërja e organizimi dhe emërimi në paragrafin 1, shprehimisht ceket si në vijim: “Dhoma e Posaçme do të përbëhet nga një numër i gjyqtarëve deri në 20, 12 për të cilët do të jenë shtetas të Kosovës, 8 do të jenë gjyqtarë ndërkombëtarë, së paku 2 nga gjyqtarët që janë shtetas të Kosovës duhet të jenë nga radhët e komuniteteve pakicë”.

Me anë të këtij projektligji, konkretisht neni i sipërpërmendur na privon nga e drejta për të pasur dy anëtarë gjyqtarë nga radhët e komuniteteve joshumicë në Kosovë, pra me Ligjin numër 04/L-033 ka qenë dy anëtarë, por tani me këtë projektligj parashihet se mund të jetë vetëm një anëtar.

Të nderuar,

Sido qoftë, ne si grup parlamentar do t'i japim përkrahje këtij projektligji në lexim të parë, me qëllim që t'i hapim rrugë për procedim të mëtutjeshëm. Ndërsa më konkretisht përmes anëtarit tonë në komision do të japim edhe rekomandimet tona. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka ministri Tahiri.

MINISTRI ABILARD TAHIRI: Faleminderit, i nderuar kryeses!

Të nderuar deputetë,

Një gjë po më çudit, një pjesë juaja kërkojnë që ky të kthehet pranë Gjykatës Themelore dhe, në anën tjetër e kundërshtoni faktin që paneli i parë të përbëhet prej një gjyqtari. Po a e dini që çështjet civile në Gjykatën Themelore nëse i nxjerrim, këto do të gjykohen prej një gjyqtari, pra s' do të ketë panel tre gjyqtarësh nëse ne e vendosim këtu në Gjykatën Themelore.

Pra, kjo është një kontradiktë, po bie që ju vetë sot po e prezantoni. Nëse e vendosim Gjykatën Themelore, këtë pra Departamentin e parë, atëherë çështjet do të trajtohen nga një gjyqtar, jo nga tre qysh është aktualisht. Dhe, ata gjyqtarë që janë në Gjykatën Themelore kanë tre vjet përvojë pune, jo tetë sa kërkohen për t'i trajtuar këto lëndët e privatizimit në kuadër të Dhomës së Posaçme.

Kjo Dhomë është krijuar ekskluzivisht për të pasur gjyqtarë më me përvojë që i trajtojmë pikërisht këto qindra a dhjetëra miliona të djersës së punëtorëve, qoftë 20%-shin, qoftë para të kreditorëve.

Pra, këqyrni propozimet tuaja pak, unë e kam thënë edhe në seancën e kaluar kur kemi debatuar për këtë. Jam për cilido propozim. Ky propozim ka ardhur në bashkëpunim pikërisht me gjyqtarët e Dhomës së Posaçme që vepron në kuadër të Gjykatës Supreme, propozimi që kjo Dhomë të mos ketë kryetar, mirëpo t'i përgjigjet kryetarit të Gjykatës Supreme ka qenë pikërisht pra i gjyqtarëve që kanë punuar për vite të tëra në këtë gjykatë, si rezultat i mosefikasitetit, pra organizimin çfarë e kemi tani, këtë strukturë të kësaj Dhome të Posaçme të gjyqësorit e ka krijuar gjendjen që ne e kemi.

Pra, ne mendojmë, edhe me projektligjin që ne e kemi propozuar, ekziston mundësia që në raste të jashtëzakonshme paneli i parë të formohet me tre gjyqtarë, pra nuk është kjo e precizuar. Mendojmë që duhet të vazhdojë të jetë Dhomë e Posaçme pikërisht për faktin që kemi gjyqtarë

dhe njerëz më me përvojë se sa në Gjykatën Themelore, ku duhet përvoja tri vjeçare që të jetë pjesë e kësaj gjykate.

Në anën tjetër, mendoj që nëse vendosim që këtë ta çojmë në Gjykatën Themelore, ju jeni të vetëdijshëm se gjyqtarët që janë në kuadër të Gjykatës Supreme nuk pranojnë të degradohen e të shkojnë të punojnë në Gjykatën Themelore, duhet një ekip e re, duhet një ekip e re, duhet një organizim i ri, duhet një riorganizim i ri komplet, realisht.

Dhe ne tash s'mund t'i sanojmë problemet edhe defektet që na kanë ndodhur për 16 vjet, prej vitit 2002, kur është themeluar kjo Dhomë e Posaçme.

Pa dyshim, pra, si rezultat i mosfunksionimit të mirë, ne e kemi gjendjen çfarë e kemi. Ne jemi të gatshëm, mund t'i ftojme edhe Gjykatën Supreme që të raportojnë para ministrisë e para komisionit në detaje, mirëpo unë s'jam sot këtu i thirrur për të raportuar për punën e tyre.

Unë mendoj që ky propozim që e ka sjellë ministria është propozimi më i mirë për të lehtësuar gjendjen e rënduar që është në kuadër të kësaj Dhome të Posaçme, djersën e këtyre punëtorëve, 21 mijë lëndë të pazgjidhura kjo është mënyra më e mirë.

Unë nuk mendoj që ne duhet të degradojmë, ta qesim në Gjykatën Themelore, mirëpo ka hapësirë dhe mund të diskutojmë dhe të zhvillojmë debat pasi që të miratohet në leximin e parë, të shohim nen për nen edhe riorganizimin në kuadër të Dhomës ne mund ta bëjmë. Pra, edhe të shohim prapëseprapë çështjen e kryetarit të Dhomës, a është më mirë që t'i përgjigjen kryetarit të Gjykatës Supreme, apo ta ketë kryetarin e vet, të gjitha këto mund t'i diskutojmë, mirëpo jo ta ndërrojmë nivelin, jo ta nxjerrim shkallën e parë në Gjykatën Themelore. Sepse unë mendoj që ne do t'i prolongojmë proceset.

Sa i përket çështjes së mandatit të gjyqtarëve të EULEX-it, ta keni të qartë, prej 14 qershorit të këtij viti gjyqtarë dhe prokurorë të EULEX-it nuk do të ketë më në institucionet tona.

Pra, pikërisht edhe mandati, edhe qëllimi i këtij ligji është zëvendësimi i këtyre shtatë gjyqtarëve të fundit që kanë mbetur në kuadër të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme.

Çështje të tjera që u ngritën, besoj që mund t'i diskutojmë edhe gjatë seancës, pra se një pjesë ka mundësi edhe që i kam harruar, se nuk kam mbajtur shënim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj, a je paraqitur më herët a jo? A dëshiron të flasësh? Zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesues!

Kolegë deputetë,

Çështja të cilën po e debatojmë është e rëndësishë së veçantë, jo pse ligjet e tjera nuk e kanë rëndësinë dhe rolin që të gjithë jemi të interesuar që sistemi i drejtësisë në vend të funksionojë në të gjitha hallkat e tij. Por, çështjen të cilën po e trajtojmë, projektligjin në fjalë, besoj që diskutimi i cili po bëhet këtu, edhe në mes grupeve politike e tregon edhe natyrën e vetë problemit.

Natyra e problemit është se Qeveria është vonuar për të sjellë këtë projektligj, duke marrë parasysh që afati apo përfundimi i misionit të EULEK-it ka qenë i ditur në kohë dhe në rrethana të caktuara dhe çështjen të cilën është dashur ta kemi përpara, mendoj edhe si temë, po edhe si synim yni në strukturën e sistemit të drejtësisë domosdoshmërisht ka kërkuar jo vetëm atë që ne po quajmë unifikim të logjikës institucionale sa i përket avancimit në këtë aspekt, por mbi të gjitha kompletimit se si ne e shohim, edhe tash, po edhe në të ardhmen, funksionimin qoftë edhe të Gjykatës Supreme.

Ajo çka është e njohur është se Gjykata Supreme edhe në sistemin tonë, por edhe në sistemet demokratike është ajka e drejtësisë dhe këtu nuk besoj që ne tash duhet të hedhim dilema a dyshime se vendimet dhe shkallshmëria brenda kësaj mund të lërë dyshime për keqpërdorime dhe për ndikim politik, sepse thirrja jonë është që të mos ketë ndikim politik, edhe pse adresimet e tillat shpeshherë janë me arsye e pa arsye.

Dhe, pjesa tjetër që ndërlidhet me fuqizimin e personit apo edhe të personave, siç është një gjyqtar i vetëm e deri te kryetari i Gjykatës Supreme, i cili e merr nën kompetencë të plotë edhe menaxhimin e Dhomës së Posaçme.

Kolegë të nderuar deputetë,

Dhoma e Posaçme në Gjykatën Supreme është vendim politik yni, nuk është vetëm pjesë, atë që ministri në fund e tha, që është dashur ta thotë në fillim, pse nuk është debatuar dhe pse është debatuar që të mos shtrihet në gjykatat themelore vendimmarrje dhe këto të jenë pjesë e asaj rregullativës, duke filluar nga faza e parë deri te vlerësimi që duhet ta japë Gjykata Supreme dhe kjo ka munguar. Ndoshta pjesa kryesore e debatit që është dashur edhe në mënyrë të shkruar të japë arsyetimin Ministria e Drejtësisë, vazhdimi i funksionimit të Gjykatës Supreme me këto ndryshime.

Për ndryshime, e thanë edhe kolegët tanë me të drejtë, sepse dyshime të plota, edhe në aspektin e vendimmarrjes, por edhe të procedimit, e mbi të gjitha edhe të ankesave.

Ne duhet t'u lejojmë individëve, qytetarëve, mbi të gjitha edhe njerëzve që janë të lidhur drejtpërdrejt me ankesat që kanë ndodhur me AKP-në dhe neve na kujtohet në të kaluarën që

këto ankesa janë refuzuar me arsye ose pa arsye, kanë qenë një farë lloj lufte mes këtij institucioni e gjykatave të rregullta, por mbi të gjitha është krijuar një monopol i shpërndarjes dhe i marrjes së vendimmarrjes me çështjet që janë ndërlidhur me privatizimit, shumica e tyre kanë qenë politike dhe këtu nuk ka dilemë, sepse vetë grumbullimi tregon që dikush ka pasur interes politik qoftë për mosshpërndarjen e mjeteve që u kanë takuar punëtorëve, qoftë edhe për kontestet të cilat kanë ndodhur mes individëve, mbi të gjitha grupeve të organizuara kriminale, të cilat kanë qenë uzurpatorë të aseteve tona shoqërore dhe kjo është një segment tjetër, i cili Ministria e Drejtësisë, po edhe Kuvendi është dashur ta nxjerrë në pah dhe ta bisedojë në organizimin e ri.

Se sa ne do të avancojmë me këtë ndryshim, për mendimin tim personal, unë mendoj që është më i avancuar, mund të jetë më profitabil, mund të jetë më proaktiv, po dyshimet për monopol dhe për keqpërdorim mbesin, sepse nuk e kemi elaboruar më herët, nuk është elaboruar edhe në këtë kohë, edhe në aspektin e përfundimit të mandatave të atyre individëve që janë parë si pengesë në marrjen e vendimeve, sepse ju e dini, në çdo panel është dashur të jetë një gjyqtar i EULEK-it, i cili më shumë nuk ka shkuar se sa ka shkuar dhe shumica e lëndëve janë bllokuar.

Çështja tjetër lidhet me mjetet e grumbulluara të Fondit të privatizimit. Qeveria e ka këtë interes, nuk po e shpreh, nuk po e tregon, është interes që mund të jetë parimor, të jetë interes i zhvillimit të vendit, por ajo çka po ndodh me parane publike, me shpërndarjen e parasë publike, personalisht për mua lë dyshime që këta e kanë interes vetëm ndryshimin ligjor, kur po them këta, po them Qeveria në tërësi, nuk po e atakoj vetëm si fokus Ministrinë e Drejtësisë përmes këtij ndryshimi, sepse prapa kësaj po fshihet ajo tendenca që përvetësimi i këtyre të hollave të jetë brenda këtij viti buxhetor kalendarik dhe ajo shpërndarje t'i mbyllë këto 'birat' që po zgjerohen apo tash po krijohen çdo ditë nga keqpërdorimi dhe shpërndarja e parave sikur të jenë të xhepit të tyre personal, kjo tregon anën e kundërt të medaljes.

Ligji është përmbajtjesor, është më i strukturuar, të jem realist, në mënyrën se si ka ardhur dhe si është historia e këtij ligji. Por, ky është vendim politik, në këtë vendim politik ne nuk mund të konsiderojmë edhe në një seancë, qoftë edhe komisioni brenda çfarëdo afati që ju i jepni.

Nëse nuk ka dakordim politik se si e shohim ne Dhomën e Posaçme dhe si e shohim, mbi të gjitha jo vetëm në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, por edhe Gjykatën Supreme në tërësi, edhe si rezultat i kësaj për të marrë një vendim, i cili është i favorshëm për interesa të qytetarëve të vendit.

Me këtë logjikë unë mendoj që ligji nuk kalon, domethënë kjo është e evidente, me këtë mënyrë të trajtimit vetëm kalon në neglizhencë të çështjeve të caktuara, të cilat janë brenda shqyrtimit tash në Dhomën e Posaçme dhe besoj që mënyra e tillë duhet të ketë një trajtim tjetër.

Ne e kemi thënë edhe në fillim, edhe në seancën e kaluar, insistimi juaj është që të vijë në këtë formë, por për mendimin tim, është i pakalueshëm pa pasur një dakordim edhe logjik, edhe politik.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër i Drejtësisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumë gjëra parafolësit i thanë, por dua të përsëris edhe ato që ne si Komision për Ligje e kemi trajtuar në dy mbledhjet e fundit dhe besoj që e kemi trajtuar me një kohë jashtëzakonisht të gjatë, që s'ka ndodhur ndoshta edhe në trajtimin e projektligjeve të kaluara.

Duke pasur parasysh edhe që është një projektligj me rëndësi, ne edhe në komision e kemi trajtuar edhe në aspektin politik, historik, shkencor, po ndoshta edhe më së paku në aspektin përmbajtësor dhe profesional.

Po ashtu sot u dëgjuan disa nga diskutuesit, nga parafolësit, edhe ata shumë gjëra i thanë në aspektin politik, sot më tepër se atë përmbajtësor, me gjithë respektin që disa nga ata edhe e trajtuan jashtëzakonisht mirë secilin nen të këtij projektligji të caktuar.

Të gjithë ne edhe në komision, po edhe në seancë sot jemi të pajtimit, të idesë se Dhoma e Posaçme nuk ka qenë efikase, efektive deri sot, e po ashtu të gjithë jemi të pajtimit për mosefektivitetin e saj dhe funksionimin jo të mirë të kësaj Dhome të Posaçme, por pa dyshim dhe pa dallim asaj që mund të aludojmë për fajin e dikujt, se mund ta ketë një gjyqtar ndërkombëtar apo një grup i gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe vendorë, apo të vetë Ministrisë së Drejtësisë si sponzorizuese e projektligjeve, gjegjësisht e ligjeve që deri më tani ka funksionuar kjo Dhomë e Posaçme, unë mendoj se fajin do ta bartim edhe ne si deputetë, sepse jemi ata që hartojmë dhe japim dorën e fundit të çdo projektligji, gjegjësisht hartimin e ligjeve.

Më lejoni, të nderuar kolegë dhe kolege, ta përgëzoj Ministrinë e Drejtësisë, gjegjësisht ministrin Tahiri për punën dhe përkushtimin që ka për hartim të politikave dhe legjislacionin në fushën e drejtësisë, si dhe reformat që ka ndërmarrë dhe do t'i ndërmarrë edhe në të ardhmen. E, në këtë aspekt edhe Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet që ndërliken me Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Besoj që ky projektligj do të ndikojë që kjo Dhomë të jetë më efikase dhe më efektive në shqyrtimin dhe zgjedhjen e lëndëve që janë në kompetencë të saj.

Pos çështjeve që ndërliken me panelet në kuadër të kësaj gjykate, ky projektligj është më i qartë dhe lehtë i kuptueshëm për faktin se nga 4 apo 5 ligje dhe plotësim-ndryshimet që kanë qenë me

rregullore të ndryshme që ne i dimë që nga koha e UNMIK-ut, tashmë kjo çështje mund të rregullohet vetëm me një ligj të vetëm. Por, një gjë nuk është e mirë që projektligjet jo rrallëherë po trajtohen në procedura të përsheptuara. Kjo mund të ndikojë në cilësi, por unë besoj se po të varej nga ministri dhe vullneti i tij, ky projektligj do të vinte shumë më herët në Kuvend. Por, duhet të kemi parasysh që kur të kemi të bëjmë me projektligje që i referohen edhe një pushteti tjetër, siç është në këtë rast, pushteti gjyqësor, edhe vonesat mund të jenë evidente. Përndryshe, ky projektligj është mirë i strukturuar, i hartuar sipas standardeve dhe besoj se duhet ta përkrahim, ndërsa në mes të dy leximeve do ta korrigjojmë, gjegjësisht është punë e komisionit, por edhe neve si deputetë që gjatë kësaj kohe të kemi propozime shumë përmbajtjesore dhe profesionale, që ky projektligj të jetë i hartuar në mënyrën më të mirë dhe në aspektin praktik dhe pragmatik t'u shërbejë edhe qytetarëve, gjegjësisht edhe neve si ligjvënës. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Sami Kurteshi e ka fjalën.

**SAMI KURTESHI:** Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Unë do të përpiqem të mos i përsëris vërejtjet dhe kërkesat e ndryshme që u dhanë në lidhje me projektligjin, por ne duhet ta kemi parasysh se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme që nga fillimi ka qenë segmenti më joefikas i krejt gjyqësorit të Kosovës, ky është një fakt. Gjyqësori i Kosovës ka vonesa të theksuara në trajtimin e lëndëve, diku 8,5 vjet është mesatarja, e Dhoma e Posaçme është domethënë ai segmenti më joefikas në krejt sistemin.

Ne dëgjuam edhe qëndrimet politike, megjithatë krijimi i Dhomës së Posaçme është bërë ndarje, domethënë është ndarë nga sistemi gjyqësor qëllimisht, jo për shkak të rritjes së efikasitetit, jo për shkak të funksionalitetit, të nivelit të profesionalizmit, por qëllimi në të vërtetë ka qenë kapja, mbrojtja e sistemit të privatizimit të pronës shoqërore në Republikën e Kosovës, me qëllim të shkatërrimit, ky proces është dëshmuar si shkatërrimtar, si i korruptuar dhe si i kriminalizuar, këtë nuk po e them unë, po e përsëris. Qëllimi që në fillim, kur është krijuar edhe Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, edhe e Privatizimit, në të vërtetë ka qenë shmangia e problemeve ekonomike e pasigurisë juridike në lidhje me këto prona, rritja e mirëqenies ekonomike, shmangia e rrezikut për investimet nga jashtë, rritja e mirëqenies sociale. Edhe, përmes mjeteve të fituara nga privatizimi të arrihet ngritja ekonomike, investimet e ndryshme.

Mendoni, a ka ngjarë ndonjëra nga këto? Me sistemin e privatizimit në përgjithësi, a ka fituar apo ka humbur Kosova? Mjetet që janë grumbulluar, për të cilat diskutohet edhe mandej vendos kjo Dhomë e Posaçme, në të vërtetë llogaritni ku mbahen, si shfrytëzohen, a shfrytëzohen për rritjen ekonomike në Kosovë? A shfrytëzohen për rritjen e kapaciteteve apo për mbrojtjen sociale? Për asnjërën nga to. A janë privatizuar organizatat e ndryshme prodhuese? Këto mjete a janë investuar në prodhim? Jo! Eventualisht nëse mund të investohen në asfalt, por edhe këtë nuk jam i sigurt. Në të vërtetë krijimi i Dhomës së Posaçme ka qenë një manovrim shumë i mirë i

aktorëve ndërkombëtarë dhe aktorëve vendorë për monopolizimin e vendimmarrjes sa i përket pasurisë shoqërore dhe publike në Kosovë, këtë duhet ta shohim.

Unë po ju lexoj pjesë të Ligjit të privatizimit që do t'i krahasoj mandej me kërkesat e Ligjit për Dhomën e Posaçme. Dëgjojeni një pjesë të paragrafit të 5-të, i nenit 18 të Ligjit për privatizimin, thotë: “Asnjë person i angazhuar ose i punësuar nga Agjencia dhe asnjë person i cili mban një pozitë menaxheriale ose të drejtorit në Agjenci në lidhje me Agjencinë nuk mban përgjegjësi personale të çfarëdo lloj nga cilado palë e tretë për dëmet, të cilat janë shkaktuar ose pretendohen të jenë shkaktuar palës së tretë, si rezultat i një veprimi ose lëshimit të Agjencisë, ose një veprimi ose lëshimi të personelit, menaxhmentit ose Bordit të Drejtorëve të Agjencisë, nëse ky veprim ose lëshim është bërë gjatë zbatimit ose ekzekutimit të autoritetit dhe përgjegjësive të Agjencisë të përcaktuara në këtë ligj ose cilido element tjetër të ligjit në fuqi në Kosovë, ose si pasojë e zbatimit të një interpretimit të arsyeshëm dhe jo qëllimkeq të këtyre autoriteteve dhe përgjegjësive”.

Edhe thotë: “Të gjitha përgjegjësitë për dëmet e shkaktuara në këtë mënyrë janë përgjegjësi ekskluzive e Agjencisë, kurse Agjencia është e detyruar t'i sigurojë dhe mbrojë fuqishëm personelin, menaxherët ose drejtorët, kundër të cilëve është ngritur një akuzë për këto dëme”. Për të shmangur dyshimin parashihet në mënyrë specifike që ky paragraf nuk pengon veprimin e asnjë dispozite të asnjë kontrate ndërmjet Agjencisë dhe cilido person të angazhuar ose të punësuar nga Agjencia që krijon detyrime dhe të drejta të dëmshpërblimit dhe obligime për palët vizavi njëra-tjetrës. Domethënë, merret, privatizohet prona shoqërore, bëhen gabimet, këtu po thotë, edhe jo të qëllimshme, por janë bërë edhe gabime të qëllimshme. Ne e dimë që për shkak të gabimeve të qëllimshme, për shkak të veprimeve korruptive dhe të kriminalizuara njerëzit kanë përfunduar me vetëvrasje ose me vrasje, ose me largime, ose me ikje. Edhe çka bëhet? Tash kjo është parimi mbi të cilin është bërë privatizimi dhe veprojnë njerëzit që punojnë në Agjencinë Kundër Privatizimit.

Qysh e mbron monopolin e privatizimit me Dhomën e Posaçme? Ndër të tjera thotë: “Asnjë gjë në këtë nen nuk paragjykon të drejtat e cilido person që jashtë Dhomës së Posaçme të ndjekë një rast apo një lëndë që nuk përshkruhet me paragrafin 1 të këtij neni”, është fjala për nenin 5 të juridiksionit, po thotë, “me kushtin që Dhoma e Posaçme ka autoritet ekskluziv për të vendosur nëse një lëndë specifike bie brenda fushëveprimit të paragrafit të këtij neni”. Domethënë, Dhoma e Posaçme vendos për çdo gjë që ka të bëjë me privatizimin. Nuk ka instancë tjetër ligjore në Republikën e Kosovës që do të mund të trajtojë as ankesë, as kërkesë të çfarëdo lloji në lidhje me privatizimin. Asnjë nga qëllimet për të cilat është krijuar Ligji mbi privatizimin nuk është arritur në Republikën e Kosovës. E dimë që është dëmtuar trupi, tërësia ekonomike e Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, për të mbrojtur këtë monopol, domethënë të privatizimit dhe të këtyre gabimeve që i lexova, thotë: “Dhoma e Posaçme ka të drejtë për të lëshuar urdhër që i kërkon



cilësdo gjykatë të Kosovës që t’i bartet secila kërkesë, lëndë, procedurë apo rast pune në gjykatë te Dhoma e Posaçme”, mandej janë çështje të tjera.

Këto janë problemet që i ka privatizimi në Kosovë, nuk ka probleme të tjera. Një herë është vendosur parimi bazë, qysh bëhet privatizimi, është bërë privatizimi, janë mjetet që nuk shfrytëzohen për arritjen e qëllimeve për çka është bërë Ligji për privatizimin, për t’u mbrojtur krejt këto krijohet një Dhomë e Posaçme, gjyqtarë që nuk po themi që janë shumë më profesionalë se të tjerët, që nuk ka treguar funksionalitet, që nuk ka treguar efikasitet, por po duam ta mbajmë kështu, mandej janë gjetur disa norma, janë futur në këtë ligj qysh të lehtësohet kjo punë. Por, sistemi gjyqësor në Republikën e Kosovës, asnjë personi në Republikën e Kosovës nuk i lejohet në asnjë mënyrë që ta ngre zërin kundër kësaj çka ka ngjarë. Sot e kemi një gjendje të tillë çfarë kemi, ekonomia e Kosovës është shkatërruar dhe përmes këtij ligji vetëm bëhen të ligjshme krejt ato veprime që kanë qenë edhe të korruptuara, që janë pranuar, edhe shkatërrimtare për ekonominë e Kosovës edhe të kriminalizuara.

Ne kemi këtu nene, unë i kam nxjerrë nga analiza të ndryshme, kemi nene që janë skandaloze, që ia humbin të drejtën ligjore çdo personi në çdo rast nga një gjyqtar i vetëm apo nga një trup i vetëm të arrijë te drejtësia. Gjykata, domethënë Apeli i Dhomës së Posaçme përsëri vendos për ankesat që i bëjnë qytetarët në raport me atë gjykatë. Domethënë, kjo është ajo shprehja e vjetër: ‘Të akuzoj, të dënoj, por krejt unë i bëj edhe s’ka kush që më ndalon këtë punë’. Nuk kanë të drejtë qytetarët. Ne i kemi parë në rastin e Fabrikës së Tubave të Ferizaj, madje edhe me vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kanë mundur të arrijnë të drejtën e tyre të kompensimit. Sot janë ata punëtorë që kurrë nuk e kanë marrë kompensimin e tyre që ia kanë pranuar gjykatat me radhë në Republikën e Kosovës, ata janë rrejtur politikisht, janë mashtruar disa herë, unë po e përmend vetëm këtë rast, ka edhe raste të tjera dhe kurrë nuk kanë arritur te e drejta e tyre. Prandaj, parimisht Ligji për privatizimin edhe Ligji për Dhomën e Posaçme...

*(Ndërprerje nga regjia)*

**KRYESUESI:** Faleminderit! Shkojmë në pauzë deri në orën 14:30.

\* \* \*

*Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës*

*Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.*

**KRYESUESI:** Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë!

Po vazhdojmë me seancën! A do kush të diskutojë? Ti ke diskutuar një herë, dy herë s'ka, veç nëse ke ndonjë replikë. Zoti Frashër Krasniqi ka replikë pak më të gjatë.

**FRASHËR KRASNIQI:** Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ne me të vërtetë i dëgjuam me vëmendje edhe komentet e ministrit, por edhe komentet e kolegëve nga pozita dhe me gjithë dëshirën që të jemi konstruktivë në këtë debat dhe në zgjidhjen e çështjes së Dhomës së Posaçme, ende e kemi të paqarta dhe të patejkalueshme disa çështje.

E para, ministri tha se si nëse e kthejmë këtë në kuadër të Gjykatës Themelore, nëse e fusim këtë Dhomë, atëherë edhe aty lëndët do të trajtohen nga vetëm një gjykatës, sepse kjo është praktika për lëndët civile. Mirëpo, mendoj që nuk mund të merret ky krahasim, sepse nëse e fusim këtë në Gjykatë Themelore, atëherë kemi të bëjmë për një sistem komplet ndryshe dhe procedura komplet të tjera, sidomos kemi të bëjmë me faktin që qytetarët do të kenë mundësi të apelojnë në Gjykatë të Apelit, gjë që është krejt tjetër kontekst në kuadër të Dhomës së Veçantë.

Sa i përket çështjes që nuk mund të degradohen gjykatësit e Gjykatës Supreme dhe të shkojnë në themelore, si gjykatës supozohet që janë më ekspertë në lidhje me çështjet e privatizimit, unë prej çka kam takuar njerëz që e njohin këtë gjykatës dhe njerëz që kanë marrë pjesë qoftë si mbrojtës apo si monitorues të rasteve të Dhomës së Posaçme, ata janë ankuar gjatë gjithë kohës për shkak që Dhoma e Veçantë e Gjykatës Supreme ka qenë institucion i përkohshëm, gjatë gjithë kohës nuk është ditur sa ka mandat, kjo e ka bërë që edhe cilësia e gjykatësve aty të jetë shumë e dobët, sepse gjykatësit profesionistë nuk kanë kandiduar në një Dhomë, afati i së cilës ka qenë i pacaktuar, pra ka qenë e përkohshme.

Kështu që nëse flasim për cilësitë prapë e konsiderojmë relative edhe cilësinë e gjykatësve aktualë në Gjykatën Supreme, le që pastaj ne ligjit jo gjithmonë mund t'i bëjmë duke u nis nga cilësitë personale ose të atyre personave që janë subjekt ose që do të prekeshin nga ky ligj. Këtu është e vërtetë që janë paraparë në kuadër të këtij projektligji që në raste të jashtëzakonshme, se e tha dikush mund të caktohen tre anëtarë në një kolegji gjyqësor, mirëpo problemi është që ky vendim për t'i trajtuar këto raste si të jashtëzakonshme prapë merret nga i njëjti institucion, nga gjykatësi mbikëqyrës, i cili është vartës i kryetarit të Gjykatës Supreme. Kështu që kjo është prapë problematike, sepse nuk e zgjidh çështjen që e kishim. Unë konsideroj që sinqerisht do të kishim dashur, po e them sinqerisht, sepse përnjëmend duam që të jemi konstruktivë në zgjidhjen e kësaj çështjeje, do të kishim dashur të dimë konkretisht, sepse nuk u tha konkretisht as nga ministri, e kam përshtypjen dhe as nga deputetët e pozitës, se si do të rritet efikasiteti dhe se si do

të përmirësohet puna e Dhomës së Veçantë përmes këtij ligji? Sepse, nuk kemi ndonjë raport ku ka pasur ngecje, cila ka qenë, domethënë qysh ka qenë puna deri më sot e kësaj Dhome të Posaçme? Ku kanë qenë mangësitë? Ku kanë qenë rezultatet e mira, në mënyrë që këto tash t'i përmirësojmë dhe t'i avancojmë me këtë ligj. E kam përshtypjen që kur po themi që ky ligj do ta përmirësojë dhe rrit efikasitetin dhe do t'i procedojë më shpejt të gjitha këto raste, nuk po na jepet një shpjegim konkret se në cilat elemente na bëjnë të besojmë ose janë ndryshe që ligj do t'i përmirësojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar deputet Krasniqi!

Pa dyshim që ky ligj do ta rrisë efikasitetin e Dhomës, nëse kalon kjo strukturë. Sepse, siç e potencova edhe më herët, deri tani kemi pesë panele në shkallën e parë të përbërë nga tre gjyqtarë. Shkalla e dytë është një panel, i përbërë nga pesë gjyqtarë, tre ndërkombëtarë dhe dy vendorë. Tashmë, ndërkombëtarët e përfundojnë mandatin.

Me ligjin që ne po propozojmë janë dhjetë panele në nivelin e parë që në rastet e jashtëzakonshme, siç e thamë edhe më herët, ku formohet panel prej tre gjyqtarëve, nëse kemi çështje të kontesteve më të mëdha që vlerëson Oda vetë, atëherë organizohet paneli prej 3 gjyqtarëve edhe në shkallën e parë. Pra, me këtë ligj ne do t'i kemi dyfishin e paneleve, jo pesë, mirëpo dhjetë që do t'i trajtojë këto 21 mijë lëndë që kanë mbete dhe nivelin e dytë nuk do ta kemi një panel, por do t'i kemi tri panele, që prapë trefishohet puna edhe në nivelin e dytë. Tash unë në parim dua t'u besoj edhe për punën e mirë edhe atyre gjyqtarëve, edhe prokurorëve dhe nuk dua të paragjykoj as në qoftë se janë të kapur apo në qoftë se janë të korruptuar, apo në qoftë se janë pjesë e krimit të organizuar, çka do qofshin ata. Mirëpo unë besoj që në atë Dhomë ka gjyqtarë të ndershëm, sepse të gjithë janë me një përvojë jashtëzakonisht të madhe të punës dhe unë nuk i fajësoj këta njerëz për neglizhencën edhe për problemet, por pikërisht struktura që ka qenë e ndërtuar mendoj që ka qenë problemi kryesor në zvarritjen, në ngecjen, në prolongimin edhe në krijimin e kësaj situatë që ne sot e kemi përpara.

Pra, unë mendoj që tash i kemi dhjetë panele në shkallën e parë, i kemi tri panele në shkallën e dytë dhe pa dyshim që kjo do ta dyfishojë angazhimin e të gjithëve pra. Shtoja faktin që gjatë kësaj periudhe po rritet edhe numri i zyrtarëve mbështetës që do të jenë pjesë e kësaj Dhome, të deleguar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, e kam theksuar edhe më herët, është për keqardhje, janë gjyqtarët e Gjykatës Supreme dhe nuk e kanë të paktën një bashkëpunëtor profesional dhe ai gjyqtar që trajton këto lëndë e kryen vetë punën e procesverbalit, punën teknike, printimin, raportin, të gjitha i shkruan vetë, pra diçka që do të duhej të kryhej prej stafit tij mbështetës. Tani me rekrutimet e fundit që kanë ndodhur nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës të bashkëpunëtorëve profesionalë dhe zyrtarëve mbështetës, kjo do të ndodhë edhe me këtë Dhomë të Posaçme, do të kenë staf mbështetës profesional, teknik, në lehtësimin e punës së tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka dy herë replikë. E bëre replikën, e bëri kundër-replikën. Zonja Haxhiu e ka fjalën si kryetare e komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Së pari, unë e dëgjova me vëmendje edhe pjesën e parë, edhe pjesën e dytë të deklaratave të ministrit në raport me këtë çështje. Për mua është e pakuptueshme se si ministri i Drejtësisë po thekson që gjyqtarët dhe prokurorët s'kanë bashkëpunëtorë profesionalë. Dakord, nuk kanë bashkëpunëtorë profesionalë dhe kjo është gabim. Prandaj, edhe shtrohet pyetja përse kur e keni sjellë pakon për sistemin e drejtësisë, Projektligjin për Prokurorinë e Shtetit, Projektligjin për gjykatat, pse aty nuk keni përfshirë dispozita, ku secili prokuror dhe gjyqtar duhet ta ketë bashkëpunëtorin e vet profesional? Ne jemi detyruar si komision që ta bëjmë, pra e kemi bërë ne si Komision për Legjislacion, diçka që është dashur ta mbulojë Ministria e Drejtësisë, duke marrë parasysh problemet që janë në këtë drejtim.

Është e vërtetë, gjyqtari e prokurori sot detyrohet edhe ftesat për palët në procedurë t'i shkruajë vetë. Por, ku është problemi dhe kush e ka, në fakt, përgjegjësinë këtu? Natyrisht, Ministria e Drejtësisë, sepse s'ka kush tjetër, Ministria e Drejtësisë, e sidomos kur i shtohet fakti që në vazhdimësi është drejtuar nga subjekti politik PDK.

Tjetra, qysh do t'ia bëni me buxhetin, për shkak se në këtë projektligj, te deklarata financiare, kërkohen edhe më shumë se 1 milion euro, sidomos duke marrë parasysh që kemi dëgjuar se s'do të ketë rishikim të buxhetit, ku do t'i merrni ato para, sepse edhe në seancën e kaluar vetë ke rënë në kontradiktë me atë që ke thënë. E para, the që "jemi duke i rekrutuar gjyqtarët" dhe e dyta, kur e shtruan çështjen e buxhetit, ju thatë se ata që janë do të veprojnë derisa të kemi buxhet. Cila është e vërteta, sepse përnjëmend është goxha vështirë të kuptohet.

Dhe, e radhës, sepse u bënë shumë dhe s'po e mbaj në mend renditjen. Është e padrejtë nga ju që të mundoheni të nxirrni vetëm një kritikë të opozitës, e të Vetëvendosjes në veçanti, në raport me këtë projektligj, që ka të bëjë me gjyqtarin dhe panelin prej 3 gjyqtarëve, për shkak e nuk është i vetëm ai kundërshtim dhe në momentin kur ne propozojmë që kjo të vijë në Gjykatën Themelore si departament, natyrisht se aty do të duhej të ishin gjyqtarët të profilizuar, s'ka kuptim ndryshe. Nuk mund të punojë dikush që nuk ka njohuri me çështjet e privatizimit dhe duke i marrë parasysh problemet që i kemi pasur ne në vazhdimësi.

Por, zoti ministër, unë e përmenda në emër të grupit edhe një çështje që ka të bëjë me mjetet juridike, gjegjësisht kompensimin në vend të kthimit të pronës te pronari. A të duket e drejtë, që në qoftë se pala e fiton rastin në Dhomën e Posaçme, siç është aktualisht, t'i bëhet kompensimi ashtu siç e ka privatizuar pronën? Ta zëmë AKP-ja 30 euro, 20 euro, dhjetë euro ka privatizuar 40 a 50 hektarë dhe çka bën AKP-ja, në qoftë se pala e fiton të drejtën, ia kompenson pronën me vlerën sa është privatizuar. Kjo është shkelje fundamentale. Prandaj, mos devijoni nga qëndrimet

e subjekteve opozitare, por përpiquni që të bëheni të paktën bashkëpunues në këtë drejtim, sepse edhe ju e dini, unë jam e bindur që ju e dini që ky projektligj është problem.

Dhe tjetra, në lajmet e mbrëmjes së KTV-së para dy-tre ditësh pashë që drejtuesi aktual i Dhomës së Posaçme, që është shqiptar, e konteston këtë projektligj, besoj se e keni parë edhe ju. Prandaj, s'po di me kë e keni bërë, sepse është problem. Në qoftë se të gjithë e kundërshtojnë, me kë e keni bërë këtë projektligj? Sepse nuk po e di sinqerisht ku po i shkruani këto projektligje dhe a po ua përshtatni rrethanave të Kosovës apo ndonjë vendi të Bashkimit Evropian apo në Amerikë, se s'po marr vesh. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Zoti ministër, urdhëro!

**MINISTRI ABELARD TAHIRI:** Nuk është marre të mos dish, po qe po të tregoj. Këta gjyqtarë janë pjesë e sistemit që promovohen nga Apeli në Supreme. Pra, në Dhomën e Posaçme nuk vijnë gjyqtarë që sapo janë rekrutuar, ose janë në rekrutim e sipër. Mirëpo, janë gjyqtarë që janë në linja buxhetore dhe këta promovohen. Ndërsa, në vitin 2017 dhe 2018 janë edhe 100 gjyqtarë të rinj që do të bëhen pjesë e sistemit tonë gjyqësor. Vetëm tani jemi në proces të rekrutimit të 39 gjyqtarëve të rinj, pastaj nga Themeloria shkojnë në Apel, e kështu me radhë.

Por, tashmë këta gjyqtarë që bëhen pjesë e Dhomës së Posaçme, në rast se ky ligj kalon, ata janë pjesë e sistemit tonë, marrin edhe paga. Thjesht, do të kalojnë në nivel më të lartë, në Gjykatën Supreme. Besoj që jam i qartë. Për këtë arsye tash për tash nuk ka kosto buxhetore, sepse njerëzit janë pjesë e sistemit, thjesht promovohen nga niveli i Apelit në atë Supreme, për këtë arsye. Ndërsa, për vitet në vijim ne kemi paraparë edhe buxhet shtesë, edhe për Këshillin Gjyqësor, edhe për Këshillin Prokurorial.

Mendoj që keni bërë një gabim jashtëzakonisht të madh. Nuk sanksionohet me ligj numri i bashkëpunëtorëve profesionalë. Kjo është çështje e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Këshilli Gjyqësor i Kosovës varësisht prej nevojave duhet t'i caktojë, t'i delegojë, bashkëpunëtorët profesionalë. Prishtina është Gjykata Themelore më e ngarkuara në Republikën e Kosovës. Nuk mund të trajtohet njësoj gjyqtari në Prishtinë dhe në Prizren, në Gjykatën Themelore të Prizrenit apo të Gjilanit, ose kudo tjetër. Ky ka qenë një gabim që e keni bërë në Ligjin për Prokurorin e Shtetit dhe unë besoj që në këto pakot e tjera nuk do ta bëni gabimin e njëjtë.

Në anën tjetër, sa u përket bashkëpunëtorëve profesionalë, asnjëherë s'ka ndodhur sikur në këtë vit. Rreth 300 bashkëpunëtorë profesionalë po bëhen pjesë e sistemit tonë të drejtësisë, tashmë rekrutimi është duke ndodhur. Pjesa më e madhe ka ndodhur nga Këshilli Gjyqësor dhe nga Këshilli Prokurorial. Pra, do t'i kenë rreth 300 bashkëpunëtorë profesionalë (zyrtarë ligjorë, zyrtarë mbështetës...) gjyqtarët dhe prokurorët tanë. Rreth 160 do të jenë në Këshillin Prokurorial, rreth 140 a 130 do të jenë në Këshillin Gjyqësor dhe një pjesë tjetër, jo e përfshirë

në këtë numër, do të jenë pjesë e Ministrisë së Drejtësisë. Ky ligj pa dyshim që është bërë me Dhomën e Posaçme. Është shumë e vërtetë, ka qenë edhe gjatë hartimit kundër kryetari i Dhomës, sepse pozita e tij është shuar, mirëpo ky propozim që të mos ekzistojë kryetari i Dhomës së Posaçme, ndërkaq Dhoma t'i përgjigjet kryetarit të Gjykatës Supreme ka dalë pikërisht prej anëtarëve nga Dhoma e Posaçme, që kanë qenë pjesë e grupit punues.

Pra, ne i kemi marrë rekomandimet e atyre njerëzve që kanë punuar për 12 a 13 vjet në këtë Dhomë të Posaçme. Tashmë, edhe po e rrisim numrin e bashkëpunëtorëve profesionalë, edhe po e ndërtojmë bazën ligjore ashtu siç duhet dhe unë besoj që s'ka si të jetë ndryshe, s'ka si të mos rritet efikasiteti në tërë gjyqësorin, sidomos sot po flasim për Dhomën e Posaçme. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Zoti Memli Krasniqi e ka kërkuar fjalën.

**MEMLI KRASNIQI:** Faleminderit!

I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë,

Ministër,

Unë mendova që ne e përfunduam para pauzës diskutimin. Sidoqoftë, meqenëse u ngritën disa çështje, unë shkurtimisht po them:

E para, sa u përket bashkëpunëtorëve profesionalë, nuk ka qenë amendament i komisionit, sa për ta saktësuar, sepse versioni që është votuar nga seanca është votuar prej seancës, bile keq të thuhet, por ka qenë propozimi siç e kam thënë unë, Albulenë, dhe jo siç e ke sjellë ti dhe ka qenë pajtueshmëri e të gjitha grupeve parlamentare që të mbështeten prokurorët me së paku një bashkëpunëtor profesional. Pavarësisht kësaj, unë mendoj që është bërë punë e mirë, pikërisht për ta lehtësuar punën e tyre.

E dyta, çështja që disa herë u diskutua edhe më herët, edhe sot, për sa i përket instancës së ankimimit, unë mendoj që sqarimi i ministrit ishte shumë i drejtë, sepse nëse paneli i shkallës së parë përbëhet vetëm prej një gjyqtari dhe paneli i shkallës së dytë, pra instanca e ankimimit përbëhet prej tre gjyqtarëve, atëherë nuk besoj se është problematike. Po ashtu, mendoj që është goxha ekuivalente fakti që nëse kthehet një departament i veçantë në Gjykatën Themelore prapë, prapë, shqyrtimi i rasteve do të jetë nga një gjyqtar dhe nuk po shoh që ka ndonjë dallim, përveç një komplikimi të mëtejshëm të situatës, meqenëse argumentet që i tha ministri s'do t'i përsëris, që asnjë prej këtyre gjyqtarëve nuk besoj se do të pranonin të kthehen në Gjykatën Themelore.

E fundit, ne e kemi në shqyrtim këtë projektligj. Ju disa jeni kundër, disa jemi pro, por mendimi im është që më së miri do të ishte që kjo të kalojë në parim dhe pastaj pikërisht Komisioni për Legjislacion dhe komisionet e tjera të përhershme të bëjnë ndryshimet e nevojshme, nëse është nevoja ndryshojeni komplet ligjin, sillet këtu, kalon ose nuk kalon. Por, nëse s'doni ta shqyrtoni

tutje, ta votojmë, dikush kundër dikush pro, veç të mos e lëmë në agoni këtë farë çështje. Nuk është fundi i botës nëse votojmë kundër dhe nëse ky ligj s'e merr mbështetjen që të kalojë në procedurë të mëtejshme. Ia kthejmë Qeverisë. pastaj këta e sjellin më vonë një ligj tjetër, vazhdon bllokimi i Dhomës së Posaçme në Gjykatën Supreme, nuk trajtohen mbi 20 mijë lëndë edhe më tutje, por e vërteta është që sikur të ketë vullnet, ne mund të bëjmë edhe zgjidhje të tjera.

Një prej ideve, që besoj se është diskutuar, ka qenë që, ta zëmë, panelet me një gjyqtar të bëhen për ato raste që mund të përcaktohen me një nivel, ta zëmë, të shumës për të cilën janë ato ankesa. Nëse mund të vendoset një gjë e tillë, besoj që mund të themi “panelet me një gjyqtar i trajtojnë rastet që kanë deri në këtë vlerë dhe rastet mbi këtë vlerë mund të kenë panele me tre gjyqtarë” dhe pastaj prapë instanca e ankimimit mund të mbetet e njëjta. Por, sidoqoftë, nëse ka kaq rëndësi për cilindo prej grupeve tona, mund ta themi votën tonë, po ose jo, pro ose kundër, dhe t'ia kthejmë Qeverisë nëse s'kalon, ose t'ua dërgojmë komisioneve për t'i bërë ndryshimet, nëse kalon. Përndryshe, prapë s'jemi duke bërë diçka tjetër, e shtyjmë. Mund të mos votohet asnjëherë, e lëmë këtë agoni në vazhdim, por mbi të gjitha ne nuk do të bëjmë zgjidhje, as zgjidhjet që po i propozoni ju, as zgjidhjet që i ka propozuar Qeveria, ose që mund t'i propozojë dikush tjetër. Faleminderit!

**KRYESUESI:** Faleminderit! Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

**MILAIM ZEKA:** Faleminderit, kryesues!

Ne të gjithë si qytetarë të Kosovës, e më në fund edhe si deputetë, e dimë që AKP-ja ka qenë kazani i shkakut të shumë tragjedi në mesin e qytetarëve të Kosovës. AKP-ja ka qenë burim i shumë vrasjeve, AKP-ja ka qenë burim i shumë vetëvrasjeve dhe ne e dimë një gjë të tillë. E dimë faktin se Serbia vetëm fabrikën e cigareve në Nish e ka shitur mbi 700 milionë euro, ndërsa ne krejt pasurinë e Kosovës e kemi shitur diku 700-800 milionë euro.

Prej vitit 2002 ekziston një piramidë e krimit që është quajtur Gjykata e Dhomave të Posaçme. As nuk ka pasur pengesë nga EULEX-i, as nuk ka pasur pengesë nga gjykatësit vendorë. Kjo gjykatë e Dhomës së Posaçme është udhëhequr nga klasa politike e Kosovës. Kjo gjykatë është udhëhequr nga njerëzit e fortë të Kosovës. E kam thënë dhe po e ripërsëris, Kosova është pronë private e njëzet personave të Kosovës. Ata që nuk guxojnë ta thonë këtë të vërtetë, është mirë të mos flasin fare, se mileti e di që ne po rrejmë, mileti di që me dhjetëra e dhjetëra mërgimtarë që kanë blerë pronë private, që kanë bërë privatizimin e pasurisë së Kosovës, sot i kanë lokalet e tyre të uzurpuara nga “mafia politike dhe ekonomike e Kosovës”. Si ka mundësi të kalojë krejt ky proces i krimit pa u burgosur asnjë njeri i Bordit të AKP-së dhe i bordeve të tjera? Ne e dimë që partitë e ndryshme politike i kanë çuar misionarët e vet në Bordin e AKP-së jo për ta udhëhequr procesin e privatizimit, por për t'i treguar mënyrat se si mund të vidhet e t'i shkaktohet dëm privatizimit. Ne e dimë një gjë të tillë. Ne e dimë që procesi i privatizimit ka

shkuar me kurdisje. I pari ka ofertuar 600 milionë, i dyti ka ofertuar 300 milionë dhe e ka marrë i dyti, sepse ka qenë kurdisje. Ka qenë kurdisje privatizimi i Grandit, ka qenë kurdisje privatizimi i Kombinatit të Drurit në Pejë, ka qenë kurdisje privatizimi i Fabrikës së amortizatorëve, që sot është Klan Kosova. Këtë e dimë, po tash këtu ju tuteni se mos po na gjuhet Klani ne e mos po bëhet nami të na shajnë neve gazetarët atje, na gjuhet Klani e nuk na thërret në emision Klani e... pastaj nuk na japin Devollët ndonjë favorizim e ... Kjo është e vërteta!

Unë i kam miq privat Devollët, unë rri me ta e pi kafe, nuk bëhet kiameti kryetari i Prishtinës që ka qëndruar atje e ka pirë birrë në vilën e Devollëve, më falni, atje në anijen e Devollëve. Problemi... jo, jo, ai s'ka qenë problem, ky është problem i kurdisur. Problem ka qenë si është kurdisur procesi i privatizimit. Ky është problemi, për të cilin ne nuk po guxojmë të flasim.

Po e përmend një rast, tha zonja deputete Albulena, a do të kemi para? Ka para Kosova, shumë ka para Kosova, por kur do të kemi para ne për gjykatës? Në momentin që do t'i ndalim hajnitë. Për shembull, në qoftë se një deputet i Kosovës dëshiron të shkojë në Londër, ose në Berlin me "Wizz Air" edhe nxjerr biletën 30 euro, Albulenë, ti nuk mundesh, se këta e kanë kurdisur një kompani të veçantë të udhëtimeve që ti duhet domosdo t'i blesh biletat përmes asaj kompanie 600 – 700 euro. Ose e ke një këshilltar të ministres Mimoza Kusari, Bernard Nikën, që sot e keni atje në delegacion në Bruksel që shkon për bisedime, a e di sa e ka paguar ai biletën për të shkuar në Tokio? 8 300 euro! Se, ka dashur njeri të shkojë me biznes klasë. E pse me 8 300 euro ne i japim këtu 30 pensione, nuk ua ndien pushtetarëve tanë! Këtu është problemi. Nuk është problemi a kemi a s'kemi para.

Te çështja e EULEX-it, ministri po thotë largohet EULEX-i, unë po ju tregoj diçka, tregohet një rrëfim popullor, që kishte qenë një zullumqar i madh që i rrihte katundin hu gardhi, e vdiq ky e u gëzua krejt katundi, por kur erdhi djali i tij në pushtet, ia ngulte hurin përmbas, edhe thanë: "Ai boll i poshtër ka qenë, veç këtë hurin përmbas nuk na e shtinte".

Këta gjykatësit tanë, jemi gjallë, këtu do të flasim, do të na e shtinë edhe hurin përmbas! A e dini pse? Sepse, pjesa dërmuese e gjykatësve janë noterë të prokurorëve. Pjesa dërmuese e gjykatësve të Kosovës nuk lexojnë fare çfarë shkruan një prokuror, por vetëm e aprovojnë propozimin e prokurorëve të korruptuar, kriminelë e idiotë.

Dhe, unë për t'jua ilustruar juve krejt këtë punë, ju lutem të nderuar deputetë, po më shumë jam duke folur me qytetarët e Kosovës, se dikush tha nuk ka logjikë ne të diskutojmë kur në sallë janë 20 deputetë. Unë mendoj që ka logjikë të flasësh këtu edhe kur është vetëm një deputet, edhe kur s'është hiç asnjë deputet, se ne po u drejtohem qytetarëve të Kosovës.

Ju lutem, të nderuar deputetë dhe qytetarë të Kosovës, shkoni dhe analizojeni kush prej AKP-së, cila "mafi politike", e ka gjuhëzuar Hysni Zogajn, i cili e ka privatizuar Minierën e Goleshit? A



e dini ju, që mbasi janë bërë pazaret prej disa politikanëve t'i shitet gurë "Bechtel&Enka"-s, kanë shkuar njeriut pas investimit 30 milionë me familjen e vet edhe me kroatë dhe ia kanë mbyllur minierën e Goleshit!

A e dini ju çfarë i ndodh një njeriut në Kosovë, një qytetari të rëndomtë e një biznesmeni të rëndomtë? A e dini ju, të nderuar deputetë, që njerëzit më të ndershëm në botë mund të bëhen terroristët më të mëdhenj të botës? Se, kur ta bien lakun këtu, nuk ke...

KRYESUESI: Milaim, të lutem, në rend ditës.

MILAIM ZEKA: Në rend jam, tash hyj unë në rend, se s'dal kurrkah, hiç mos ta ndien ty, në rend jam.

KRYESUESI: Jo, s'je në rend hiç.

MILAIM ZEKA: E detyrohen që kjo... kjo Gjykata e Dhomave Speciale i ka shtirë njerëzit, edhe të vrasin, edhe të bëjnë vetëvrasje, edhe të bëhen terroristë. Këtu po dua të dal në rend.

Dhe, unë drojën më të madhe e kam që vendimi i një gjykatësi, këtu njeriu që e vret njeriun del i lirë dhe shëtit nëpër rrugë. Unë frikohem që vendimi i një gjykatësi do të jetë shumë lehtë për një njeri të paguhet dhe të korruptohet gjykatësi. Këtu e kam unë frikën, jo te diçka tjetër.

Prandaj, në qoftë se ne që 16 vjet e kemi duruar që Dhoma e Posaçme të mos i trajtojë 21 300 lëndë, ne nuk guxojmë si deputetë të Parlamentit të Kosovës të bëjmë veprime të ngutshme vetëm për hir se na thotë Bashkimi Evropian. Unë personalisht si deputet në leximin e parë do ta përkrah këtë ligj, por i ftoj të gjithë deputetët, që ta shikojnë me llupë të veçantë këtë ligj në leximin e dytë, sepse i bashkëngjitem mendimit të të gjithë deputetëve, se është njëri prej ligjeve më të rëndësishme. Prandaj, mbi bazën e kësaj edhe një herë ju bëj thirrje publike që të jemi të vëmendshëm në leximin e parë, ndërsa unë personalisht, ministër, për hir të proceseve e përkrah ligjin në leximin e parë.

Për gjëra të tjera kemi kohë, do të flasim herë tjetër. A mos kam dalë prej teme, kryesues? Kërkoj falje!

KRYESUESI: Po përmend emra ti nganjëherë, po mos i përmend fort. Igor Simiq e ka fjalën.

IGOR SIMIĆ: Hvala, predsedavajući!

Pitanje ovog zakona je od izuzetnog značaja i ono što mogu da kažem jeste da je Odbor za zakonodavstvo podobno analizirao ovaj zakon.

Svi se slažemo da je proces privatizacije bio urađen na loš način i da posledice tog postupka trpe svi građani. Ono što mogu da kažem jeste da smo unutar Poslaničke grupe Lista Srpska posebno analizirali određene elemente ovog zakona i sada ću ukratko da ukažem na one koji štete samom zakonu. Pre svega, kada je u pitanju zastupljenost nevećinskih zajednica unutar ove komore zakonom je predviđeno da samo jedan predstavnik nevećinskih zajednica bude u ovoj komori, što smatramo da nije adekvatno i ne predstavlja etničku strukturu na Kosovu.

S druge strane, smatramo da se članovi nevećinskih zajednica kao članovi ove komore moraju uključiti u one postupke, koji se odnose na preduzeća ili imovinu koja se nalaze u opštinama se srpskom, odnosno nealbanskom većinom. Ono što je strašno, ja očekujem da ministarstvo mora o tome da vodi računa, jeste da određene formulacije ovog zakona krše Evropsku konvenciju o ljudskim pravima, konkretno stav 5 člana 9 uvodi pravo sudije da bez izvođenja postupka ili podnošenja dokaza na osnovu slobodnog sudijskog uverenja, odluči dali stranka ima, odnosno nema pravo na pravni lek. Ovo je prejaka snaga koja se daje sudijama i direktno ugrožava član 6 i 13 Evropske konvencije o ljudskim pravima, odnosno pravo na pravično suđenje i pravo na delotvorni lek.

Takođe, član 10, stavovi 2, 3, 4 i 5, govore o tome da Posebna komora u postupcima vezanim za preduzeća, korporacije i imovinu, koja je pod upravom Agencije za privatizaciju, nikada ne vraćaju pravo svojine trećim licima, odnosno pravo državine zakonitim vlasnicima, čak iako vlasnici u postupku pred ovom komorom dokažu da su legitimni nosioci prava svojine. Šta više, ovaj zakon ide dalje i kaže da vlasnici mogu dobiti samo novčanu kompenzaciju i to ne u punoj tržišnoj vrednosti preduzeća, korporacije ili imovine, već iz sredstava koja su dobijena prodajom preduzeća, korporacije ili imovine.

Ovo direktno znači da su ove odredbe suprotne članu 1, protokola 1, Evropske konvencije o ljudskim pravima, koji propisuje da niko ne može da bude lišen prava na svoju imovinu a ukoliko se to desi iz javnih razloga, imovina mora biti nadoknađena vlasniku u punoj kompenzaciji u vrednost imovine. Sve suprotno navedeno na odredbi protokola 1 predstavlja prikrivenu eksproprijaciju zakonite svojine i suprotno i načelima modernih pravnih sistema. Mislim da je i to bio jedan od razloga što smo na Odboru zakonodavstva potrošili možda i najviše vremena analizirajući ovaj zakon u odnosu na druge zakone. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sejdiu, keni replikë apo çfarë keni?

KORAB SEJDIU: Edhe një herë shkurtimisht, sepse u aludua në disa gjëra, që besoj se nuk janë të vërteta, ose së paku nuk janë në përputhje me realitetin. U tha që nëse shkohet në Themelore, që në fakt nuk është trajtuar mirë, ose nuk është menduar mirë për këtë, sepse aty vendosen lëndë nga një gjyqtar, ata gjyqtarë nuk i përmbushin kriteret, e kështu me radhë, po në fakt ne jemi duke e trajtuar një ligj, me anë të të cilit ne do të mund t'i krijonim të gjitha këto kushte për

trajtimin e këtyre lëndëve. Pra, edhe të themelohet, nëse dëshirojmë si departament, edhe të vendosim kritere për gjyqtarët që shërbejnë aty, edhe të vendosim se a duhet të jetë një gjyqtar a tre gjyqtarë, kështu që kjo është pak një qasje jo e drejtë, besoj, sepse është pikërisht ky projektligj për të cilin po diskutojmë edhe si ta formësojmë mënyrën më të mirë të mundshme.

Çështja tjetër që u aludua është se ne nuk mund t'i adresojmë ose t'i përmirësojmë gabimet e 16 vjetëve të kaluara. Unë mendoj që përshkrimi i vendit të punës edhe për ministra, edhe për deputetë është pikërisht kjo: të adresohen edhe të përmirësohen sipas mundësisë edhe gabimet në të kaluarën, edhe ato sfida aktuale, po ndoshta edhe të parashikohen sfidat e së ardhmes që mund t'i sjellë.

Kështu që ne për atë e kemi këtë detyrë. Unë besoj që ky projektligj nuk do t'i zgjidhë të gjitha problemet që kanë ndodhur në Agjencinë Kosovare për Privatizim ose edhe paraardhësen e këtij institucioni. Mirëpo çka mund ne të kontribuojmë është që ky institucion, i cili është hapi i fundit para se të kryhen këto lëndë, ta bëjmë në mënyrën më të mirë të mundshme që t'u shërbejmë qytetarëve, edhe tash unë besoj që edhe ministri e sheh që është para një vendimi që a ta tërheqë ligjin e t'i marrë të gjitha këto vërejtje t'i përmirësojë në një afat sa më të shkurtër kohor e t'i adresojë në ligj, apo të tentojë ta shtyjë përpara dhe të qëndrojë këtu. Unë nuk po shoh që ka disponim përkrahja e këtij ligji, por sidoqoftë, të mundohemi që nëse kalon, nëpërmes amendamenteve, që unë besoj që kanë me goxha voluminoze që ndoshta edhe ia rishkruajnë ligjin. Tash nuk po di sa ka kuptim kjo, kështu që le të jetë në vlerësim.

**KRYESUESI:** Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur për diskutim.

Fjalën, sipas Rregullores, e ka përfaqësuesi i Qeverisë, në qoftë se e kërkon. Zoti Tahiri, e keni fjalën.

**MINISTRI ABELARD TAHIRI:** Të nderuar deputetë,

Unë ju kërkoj që ta votoni në parim këtë projektligj. Mirëpo, gjithsesi është mirë të votohet të paktën edhe nëse jeni kundër, t'i kthehet Qeverisë dhe të fillojmë me një grup të ri punues dhe të fillojmë, të mos humbim kohë, të mos mbetet pa u votuar, të mos humbim kohë dhe ta dimë pozicionin e qartë karshi kësaj Dhome dhe karshi këtyre gjykatësve.

Pra, thjesht të mos paguajmë gjyqtarë, të cilët nuk e kryejnë punën e tyre, tani e tutje kjo Dhomë nuk ka kuorum, nuk mund të vazhdojë punën, edhe në qoftë se votohet kundër, gjë që unë s'kisha dëshiruar, mirëpo edhe në qoftë se votohet kundër, të paktën të mos humbim kohë edhe të fillojmë që nga sot organizimin, mënyrën se si duhet të organizohet.

Por po shpresoj që do të kalojë në parim dhe e kemi mundësinë që në lexim të dytë edhe në komision, edhe me deputetë të diskutojmë për çdo amendament veç e veç, mirëpo sido që të jetë është mirë që kjo çështje të marrë sot epilog. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Dua t'ju njoftoj se në sallë kemi kuorumin e mjaftueshëm, janë 62 deputetë, respektivisht 63 tani. Unë e nxjerr në votim këtë çështje. Ju lus të përgatiteni për votim. Edhe një herë po e përsëris, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në sallë kemi 75 deputetë, votojmë tani.

E përsëris edhe një herë votimin, sepse nuk kanë votuar të gjithë dhe në të njëjtën kohë i porosis edhe kryetarët e grupeve parlamentare të pozitës, në qoftë se duan të kalojnë ligjet, të gjithë deputetët duhen të jenë në sallë. Në qoftë se një deputet mungon, mos prisni që ligjet t'i votojë opozita, veçanërisht kur nuk është dakord me to.

Edhe një herë e përsëris, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

E kalojmë në pushim të përkohshëm deri në seancën tjetër, kur të bëhen deputetët. Nuk po votojnë një pjesë e deputetëve, kanë votuar vetëm 54 deputetë, dy herë. Kështu që në seancat e radhës duhet ta nxjerrim në votim prapë.

\* \* \*

*E enjte, më 12 korrik 2018*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 9 korrik 2018*

*Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.*

***1. Votimi në parim i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit***

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

57 deputetë kanë votuar. 44 për, 5 kundër dhe 8 abstenime. Nuk ka vota të mjaftueshme, edhe një herë e hedh në votim.

Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

58 deputetë kanë votuar. 44 për, 6 kundër dhe 8 abstenime. Nuk ka vendimmarrje.

\* \* \*

E kthejmë edhe një herë.

***1. Votimi në parim i Projektligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit***

Votojmë tash:

66 deputetë kanë votuar, 46 për, 14 kundër dhe 6 abstenime. Kuvendi e miratoi në parim në Projektligjit 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

*E përgatiti:*

*Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*